


KAPITULLI IV. FUNKSIONE DHE ANGAZHIME TË TJERA INSTITUCIONALE

IV.1 EMISIONI I MONEDHËS

Sipas Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, Banka e Shqipërisë ka të drejtën ekskluzive të nxjerrjes e të qarkullimit të monedhës kombëtare, Lek. Banka e Shqipërisë përcakton format, masat, peshat, modelin dhe karakteristikat e tjera të kartëmonedhave dhe monedhave metalike shqiptare, me kurs ligjor brenda vendit, si dhe të monedhave e kartëmonedhave që do të shtypen për qëllime numizmatike.

- *KARTËMONEDHA DHE MONEDHA NË QARKULLIM¹*

Në fund të vitit 2012, rezultuan në qarkullim 137,824,961 copë kartëmonedha me vlerë rreth 197.699 miliardë lekë. Në krahasim me vitin 2011, rezulton një ulje e vëllimit të numrit të kartëmonedhave me 5.1%, dhe një ulje prej 1.1% e vlerës së tyre. Ndryshimi i këtij treguesi vjen si pasojë e ndryshimit të lehtë që ka pësuar struktura në favor të kartëmonedhës me vlerë nominale 5000 Lek. Gjithashtu, volumi i kërkesave nga bankat e nivelit të dytë për pagesa pati një rënie të lehtë.



Në fund të vitit 2012, rezultuan 130,683,932 copë monedha metalike në qarkullim, me vlerë 3.172 miliardë lekë. Në krahasim me vitin 2011, ka një

¹ Është numri dhe vlera e kartëmonedhave të hedhura në qarkullim nga Banka e Shqipërisë.

rritje të numrit të monedhave metalike me 5.8% dhe një rritje të vlerës së tyre me 4.7%. Këtë vit struktura e monedhës metalike pati ndryshime të vogla si pasojë e një rritjeje të lehtë të peshës së monedhave metalike me vlerë nominale 10 lekë dhe 1 lek. Në fund të vitit 2012, raporti i përgjithshëm midis vlerës së monedhës metalike ndaj kartëmonedhës rezultoi më i lartë se viti i kaluar.

- *TREGUES TË QARKULLIMIT TË PARASË*

Në fund të vitit 2012, raporti i parasë në qarkullim ndaj agregatit M2 ishte 30.0%², ndërsa në fund të vitit 2011 i njëjti raport ishte 31.84%. Koeficienti i qarkullimit të parasë³ në Bankën e Shqipërisë në vitin 2012, rezultoi 0.496 ndërkohë që për vitin 2011 ishte 0.536. Kjo tregon që bankat e nivelit të dytë, në raport me paranë në qarkullim, kanë kthyer me pak para pranë arkave të Bankës së Shqipërisë. Gjithashtu vlera mesatare e një kartëmonedhe në qarkullim në fund të vitit 2012 arriti në 1,434 lekë, nga 1,376 lekë që ishte në fund të vitit 2011.

- *RICIKLIMI I CASH-IT DHE CILËSIA E KARTËMONEDHËS NË QARKULLIM*

Gjatë vitit 2012, u përpunuan 126 milionë copë kartëmonedha, të cilat u kontrolluan për autenticitet dhe përshtatshmëri për riqarkullim. Nga përpunimi rezultuan rreth 20.5 milionë copë kartëmonedha të papërshtatshme për përdorim, të cilat u tërhoqën nga qarkullimi. Norma e sortimit⁴ ishte 16.27% dhe pati një ulje prej 2.13% nga viti i kaluar. Kartëmonedhat e dëmtuara janë zëvendësuar rast pas rasti me kartëmonedha të reja të përshtatshme për qarkullim. Koeficienti⁵ i qarkullimit të kartëmonedhës për vitin 2012 rezultoi në vlerën 0.948, që do të thotë se një kartëmonedhë kthehet mesatarisht një herë në vit në sportelet e Bankës së Shqipërisë. Ky koeficient është me i lartë për prerjet 200 lekë, 500 lekë (rreth 1.1 dhe rreth 1.8) dhe me i vogël për prerjet 5000 dhe 2000 lekë (rreth 0.2) që tregon se këto të fundit kthehen më rrallë në sportelet e Bankës së Shqipërisë.

- *MBROJTJA E KARTËMONEDHËS DHE MONEDHËS METALIKE NGA FALSIFIKIMI*

Gjatë vitit 2012, numri i kartëmonedhave dhe monedhave metalike të falsifikuara ka qenë shume i vogël dhe në raport me sasinë e monedhave metalike dhe kartëmonedhave në qarkullim, përbën një shifër të papërfillshme. Kartëmonedhat e evidentuara të falsifikuara, sipas analizës teknike, janë kryesisht riprodhime me inkjet-toner në makina riprodhuese (skanimi apo fotokopjimi) me ngjyra, duke realizuar në disa raste imitimimin e disa elementeve

² Vlera për agregatin M2 është bazuar në të dhënat paraprake për muajin dhjetor 2012.

³ Është raporti i numrit të kartëmonedhave dhe monedhave metalike të arkëtuara në sportelet e Bankës së Shqipërisë mbi gjendjen mesatare vjetore të numrit të kartëmonedhave dhe monedhave në qarkullim.

⁴ Është raporti i numrit të kartëmonedhave dhe monedhave metalike të papërshtatshme mbi numrin total të kartëmonedhave të përpunuara gjatë një viti.

⁵ Është raporti i numrit të kartëmonedhave të arkëtuara në sportelet e Bankës së Shqipërisë mbi gjendjen mesatare vjetore të numrit të kartëmonedhave në qarkullim.

të sigurisë në kartëmonedha me cilësi të dobët dhe në letër të zakonshme printimi.

Nga krahasimi i sasive të monedhës kombëtare të sekuestruar në sistemin bankar gjatë vitit 2012 me ato të sekuestruara në vitin 2011, rezultojnë 69.1% më pak kartëmonedha të falsifikuara. Gjithashtu, konstatohet një rënie me 4.7% e numrit të monedhave të falsifikuara.

- *NUMIZMATIKA NË BANKËN E SHQIPËRISË*

Gjatë vitit 2012, fondi numizmatik i Bankës së Shqipërisë u pasurua me monedha të reja.

Në muajin shtator, u prezantua për koleksionistët dhe publikun, monedha 50 lekë me metal argjend, me tematikë “Kodiku i Purpurtë i Beratit 043 ø - Beratinus 1”, viti 2011.



Në kuadër të përkujtimit të ngjarjes më të rëndësishme kombëtare, 100-vjetorit të Pavarësisë së Shtetit Shqiptar, Banka e Shqipërisë shtypi një seri me tre monedha pa kurs ligjor dhe të një medaljoni. tematika e tyre qe: “100-vjetori i Shpalljes së Pavarësisë - 2012”.



Monedha metalike, 200 lekë, pa kurs ligjor, viti 2012, në metal ar



Monedha metalike 100 lekë, pa kurs ligjor, viti 2012, në metal argjend



Monedha metalike 50 lekë, pa kurs ligjor, viti 2012, metal i thjeshtë



Medaljon “100-vjet Pavarësi - 2012”, metal i thjeshtë

Gjithashtu, gjatë vitit 2012 u përfundua shtypja e një monedhe përkujtimore 200 lekë, pa kurs ligjor, në metal ar, kushtuar Nënë Terezës.



Seria e monedhave dhe medaljoni kushtuar 100-vjetorit të Shpalljes së Pavarësisë si dhe monedha kushtuar Nënë Terezës u prezantuan për publikun në muajin nëntor, të vitit 2012.

Në kuadrin e kremtimeve të 100-vjetorit të Pavarësisë së Shtetit Shqiptar, Banka e Shqipërisë zhvilloi ekspozitën numizmatike të lëvizshme me tematikë “100-vjetori i Pavarësisë, pasqyrimi i historisë në monedhën tonë kombëtare” në 7 qytete të vendit dhe në kryeqytetin e Kosovës, Prishtinë. Kjo ekspozitë solli një risi në kuadrin e aktiviteteve të organizuara, jo vetëm nga Banka e Shqipërisë por edhe në vendin tonë, pasi ajo ishte e para e këtij lloji si për mënyrën e ekspozimit të objekteve në stenda, ashtu edhe për prezantimin e alternuar të historisë së shtetit shqiptar me atë të monedhës kombëtare. Në përmbajtjen e saj, ekspozita trajtoi momentet më kryesore të historisë, figurat më të shquara të kombit shqiptar, të reflektuara në konfigurimet, shkrimet dhe datimet e gjithë kartëmonedhave dhe monedhave të shtypura e qarkulluara në Shqipëri, që nga momenti i shpalljes së Pavarësisë.

IV.2 SISTEMI I PAGESAVE

Në përmbushje të përgjegjësisë së saj ligjore, Banka e Shqipërisë nxit funksionimin normal të sistemeve të pagesave me qëllim mbështetjen e implementimit të politikës monetare dhe ruajtjen e stabilitetit financiar dhe të besueshmërisë së publikut në monedhën kombëtare. Për të përmbushur këtë objektiv, Banka e Shqipërisë është e përfshirë në tre role të ndryshme: atë operacional, mbikëqyrës dhe katalizator të sistemeve të pagesave.

Gjatë vitit 2012, transaksionet ndërbankare në monedhën kombëtare Lek janë kleruar dhe shlyer me efikasitet dhe siguri, sipas rregullave dhe procedurave të dy sistemeve të operuara dhe të administruara nga Banka e Shqipërisë: “Sistemit të Shlyerjes së Pagesave Ndërbankare me Vlerë të Madhe - AIPS” dhe “Sistemit të Klerimit të Pagesave me Vlerë të Vogël – AECH”. Në fund të vitit 2012, të gjitha bankat dhe degët e bankave të huaja, të cilat operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë rezultojnë të jenë anëtare të drejtpërdrejta të sistemeve.

IV.2.1 SISTEMET E PAGESAVE AIPS DHE AECH

• SISTEMI I SHLYERJES SË PAGESAVE NDËRBANKARE ME VLERË TË

MADHE - AIPS

Gjatë vitit 2012, në sistemin AIPS janë procesuar 77,090 transaksione me vlerë totale prej afërsisht 6,743 miliardë lekë. Ky sistem ka qenë në operuar për 252 ditë, duke procesuar rreth 306 transaksione/ditë dhe me një qarkullim ditor prej 26.76 miliardë lekësh. Ritmet vjetore të numrit të transaksioneve të procesuara në këtë sistem tregojnë për një rritje 2.42% krahasuar me vitin 2011, ndërkohë që një rritje të konsiderueshme prej 65.07% ka shënuar vlera e transaksioneve. Nga një këndvështrim më afatgjatë vihet re se, sistemi AIPS gjatë këtij viti ka patur qarkullimin më të lartë vjetor të likuiditetit që prej fillimit të operimit të vet.

Sistemi AIPS	2008	2009	2010	2011	2012
Numri i transaksioneve	56,717	55,701	80,356	75,269	77,090
Vlera e transaksioneve (miliardë lekë)	5,146	4,718	4,437	4,085	6,743
Vlera mesatare për transakcion (milionë lekë)	91	85	55	54	87

Burimi: Banka e Shqipërisë.


Tabelë 1. Ecuria e aktivitetit të sistemit AIPS.

“Pagesat për klientë” kanë zënë peshën kryesore të numrit të transaksioneve ndaj totalit, ndërsa “Instrumentet financiare të BSh-së” janë lloji i transaksionit me peshën kryesore në terma të vlerës, pavarësisht faktit se ky i fundit është mjeti më pak i përdorur në sistemin AIPS.

Tabelë 2. Llojet e transaksioneve në sistemin AIPS.

Lloji i transaksionit	Numri		Vlerë (në milionë lekë)	
	Vlerë absolute	Peshë relative	Vlerë absolute	Peshë relative
Instrumente financiare të BSh-së	3,674	4.77%	3,778,576.42	56.03%
Transferta cash për/nga emisioni	8,398	10.89%	224,993.73	3.34%
Transferta ndërbankare	8,233	10.68%	1,369,221.39	20.3%
Pagesa për klientët	49,013	63.58%	745,522.17	11.06%
Shlyerje për sistemet e klerimit neto	7,772	10.08%	625,115.47	9.27%
Totali	77,090	100%	6,743,429.18	100%

Burimi: Banka e Shqipërisë.



Pasqyrimi i llojeve të transaksioneve të procesuara dhe të shlyera për vitin 2012 tregon se rritja në vëllimin e transaksioneve të procesuara i atribuohet kryesisht "Transfertave ndërbankare" dhe "Instrumenteve financiare të BSh-së" të cilat kanë patur rritje respektive në numër prej 1,321 (ose 19%) dhe 409 (ose 12.5%) transaksione më shumë se vitin e kaluar. Përsa i përket vlerës, të gjitha llojet e transaksioneve kanë patur rritje në krahasim me vitin e kaluar, ku përmendim "Instrumente financiare të BSh-së" me 111.38% dhe "Pagesat ndërbankare" me 76.66%.

Treguesi i përqendrimit tregon peshën të cilën zënë bankat më aktive të sistemit ndaj totalit të aktivitetit të AIPS. Kështu, katër bankat më aktive në sistemin AIPS zënë një peshë prej 51.38% në numër dhe 73.34% në vlerë ndaj totalit të bankave pjesëmarrëse në sistem (këtu nuk përfshihen Banka e Shqipërisë dhe Ministria e Financave). Gjithashtu, rritje të konsiderueshme gjatë këtij viti ka patur dhe numri total i transaksioneve të iniciuara nga bankat, 5,567 transaksione më shumë se në vitin 2011 (ose rreth 15%).

Tabelë 3. Treguesi i përqendrimit për sistemin AIPS.

Sistemi AIPS	Numri i transaksioneve	Vlera e transaksioneve (në miliardë lekë)
4 banka*	21,854	2,885.7
Pesha ndaj totalit (%)	51.38	73.34
Totali	77,090	6,743.4

* Nuk përfshihet Banka e Shqipërisë dhe Ministria e Financave.
Burimi: Banka e Shqipërisë.

Gjatë vitit 2012, nevojat e pjesëmarrësve në sistemin AIPS për likuiditet brenda ditës kanë qenë lehtësisht më të larta krahasuar me një vit më parë. Bankave u janë akorduar 270 kredi njëditore (ILF)⁶ me një vlerë totale prej 90.8 miliardë lekësh, duke reflektuar kështu një rritje vjetore të numrit dhe të vlerës së ILF-ve përkatësisht me 10.2% dhe 7.9%.

Tabelë 4. Përdorimi i kredisë brenda ditës (ILF) në sistemin AIPS.

Sistemi AIPS	2008	2009	2010	2011	2012
Numri i ILF-ve	579	207	278	200	270
Vlera e ILF-ve (në miliardë lekë)	221.43	120.55	74.99	84.39	90.8
Vlera mesatare (në milionë lekë)	382.44	582.34	269.76	421.95	336.28

Burimi: Banka e Shqipërisë.

Zhvillimet e Kredisë Brenda Ditës ndër vite, paraqesin një prirje rënëse, duke nënkuptuar reduktimin gjithnjë e më të ndjeshëm të financimit të aktivitetit të AIPS me ILF. Rënia e raportit ILF/vlera totale e transaksioneve në AIPS tregon për një zbehje gjithnjë e më të ndjeshme të rrezikut të likuiditetit në këtë sistem. Gjatë vitit të kaluar (2011) financimi me anë të ILF-së përbënte 2.07% ndaj totalit të qarkullimit në AIPS, ndërsa këtë vit (2012) ky tregues ka patur një rënie të mëtejshme në 1.35%.

⁶ Kredia Brenda Ditës (ILF) është një instrument financiar i ofruar nga Banka e Shqipërisë për t'u ardhur në ndihmë me likuiditet ditor institucioneve bankare, të cilat marrin pjesë në sistemet e pagesave të operuara nga Banka e Shqipërisë.

- **SISTEMI I KLERIMIT TË PAGESAVE ME VLERË TË VOGËL - AECH**

Në sistemin AECH procesohen dhe klerohen pagesat e klientëve me vlerë nën 1.5 milionë lekë. Sistemi vepron i ndarë në tre seanca ditore. Gjatë vitit 2012, në këtë sistem u procesuan 361,552 urdhërpagesa, me një vlerë mesatare për transaksion të shlyer prej 190 mijë lekësh.

Sistemi AECH	Janar-Dhjetor 2011	Janar-Dhjetor 2012
Numri i transaksioneve	388,208	361,552
Vlera e transaksioneve (milionë lekë)	64,097.88	66,990.11
Vlera mesatare e transaksionit (milionë lekë)	0.17	0.19

Burimi: Banka e Shqipërisë.

Tabelë 5. Ecuria e aktivitetit të sistemit AECH.

Mesatarisht, çdo ditë në sistemin AECH janë procesuar rreth 1,435⁷ pagesa, me një vlerë mesatare ditore prej 265.83 milionë lekësh. Duke e krahasuar me vitin e kaluar, numri i pagesave të kleruara ka një ulje prej 7% (ose prej 26,656 transaksionesh). Ndërsa në terma të vlerës, ka një rritje të lehtë prej 5% (ose prej 2,892.23 milionë lekësh). Rënia vjen si rezultat i uljes së numrit të pagesave të procesuara nga Ministria e Financave, duke qenë se kjo e fundit zë peshën më të madhe në procesimin e pagesave në këtë sistem. Ministria e Financave vazhdon të jetë kontribuuesi kryesor në procesimin e pagesave me vlerë të vogël, përkatësisht me 66% në numër dhe me 58% në vlerë. Gjatë vitit 2012, vëmë re se ka një rritje të numrit të pagesave të procesuara nga bankat (me rreth 32 mijë pagesa, ku nuk përfshihet Banka e Shqipërisë). Kjo rritje vjen si rezultat i ndryshimeve në vlerën kufi të pagesave nga 1.0 milionë, në 1.5 milionë lekë si dhe shtimi i një seance të tretë klerimi. Treguesi i përqendrimit reflekton peshën që zënë 4 bankat më aktive në sistemin AECH, kundrejt totalit të aktivitetit në këtë sistem. Bankat më aktive zënë një peshë prej 59.75% në numër dhe 63.35% në vlerë, kundrejt totalit të pagesave të kryera nga bankat pjesëmarrëse në sistemin AECH100.

Sistemi AECH	Numri i transaksioneve	Vlera e transaksioneve (në miliardë lekë)
4 Banka*	68,061	17.13
Pesha ndaj totalit (%)	59.75	66.35
Totali	361,552	66.99

* Nuk përfshihen Banka e Shqipërisë dhe Ministria e Financave.

Burimi: Banka e Shqipërisë.

Tabelë 6. Treguesi i përqendrimit për sistemin AIPS.

IV.2.2 INSTRUMENTET E PAGESAVE

Statistikat e bankave tregojnë se në fund të vitit 2012 llogaritë rrjedhëse të klientëve, në monedhë kombëtare apo në valutë kanë pasqyruar një rritje prej 3% nga 7.7% në vitin 2011.

⁷ Sistemet AECH dhe AIPS kanë operuar për një total prej 252 ditësh gjatë vitit 2012.

Tabelë 7. Ecuria e llogarive të klientëve.

Përshkrimi i llogarisë	Totali i llogarive të klientëve			Të aksesueshme nga interneti		
	2010	2011	2012	2010	2011	2012
Llogaritë e klientëve (1+2)	2,446,495	2,634,971	2,724,668	27,368	37,138	54,926
1-llogari të rezidentëve (a+b)	99%	99%	99.3%	97%	98%	98%
a - individuale (%)	92%	94%	94%	66%	75%	80%
b - kompani (%)	8%	6%	6%	34%	25%	20%
2-llogari të jo rezidentëve (c+d)	1%	1.2%	0.69%	3%	1.95%	2.2%
c - individuale (%)	94%	87%	95%	80%	78%	87.4%
d - kompani (%)	6%	12%	5%	20%	21.6%	12.6%

Burimi: Banka e Shqipërisë (raportimet nga bankat sipas "Metodologjisë për raportimin e instrumenteve të pagesave).


Gjatë vitit 2012 rezultojnë të jenë kryer rreth 8.8 milionë pagesa klientësh me një vlerë totale prej 3,719 miliardë lekësh, duke reflektuar një rritje vjetore të numrit me 9% dhe një rënie të vlerës me 5%. Transfertat e kreditimit të klientëve zënë një peshë prej 75% në vëllim dhe 95% në vlerë, kundrejt totalit të transfertave të klientëve. Gjithashtu, në transfertat e klientëve vazhdojnë të dominojnë ato në formë letër (rreth 96.4%), përkundrejt transfertave në formë elektronike (rreth 3.6%).

Tabelë 8. Peshat e pagesave të klientëve sipas instrumentit të pagesës.

Shërbime pagesash për klientët	Viti 2010		Viti 2011		Viti 2012	
	Numër	Vlerë (miliardë lekë)	Numër	Vlerë (miliardë lekë)	Numër	Vlerë (miliardë lekë)
I. Transferta kreditimi të klientëve nga të cilat:	81%	94%	79.15%	95.23%	75.5%	95%
1. Transfertë krediti formë letër	97%	97%	97.05%	97.25%	96.4%	96.69%
2. Transfertë krediti e-banking"	3%	3%	2.95%	2.75%	3.5%	3.32%
II. Pagesat me karta në POS nga të cilat:	7%	0%	9.33%	0.28%	12.7%	0.36%
1. Pagesat me karta debiti	61%	42%	61.09%	43.23%	59.2%	35.3%
2. Pagesat me karta krediti	39%	58%	38.91%	56.77%	40.7%	64.6%
III. Debitimi direkt	11%	4%	10.75%	2.29%	11.14%	2.41%
IV. Çeqet	1%	2%	0.77%	2.20%	0.72%	2.2%
Totali pagesave (I+II+III+IV)	7,377,033	3,398,102	8,038,656	3,899,439	8,758,818	3,719,562

Burimi: Banka e Shqipërisë (raportimet nga bankat sipas "Metodologjisë për raportimin e instrumenteve të pagesave).

Grafik 3. Numri i ATM-ve dhe POS.




Numri i bankave të licencuara si emetuese kartash në Republikën e Shqipërisë në fund të vitit 2012 rezulton 14, i njëjtë me atë të vitit të kaluar. Nga bankat e licencuara si emetuese kartash, vetëm 7 rezultojnë njëkohësisht të licencuara edhe si pranuese kartash. Përsa i përket infrastrukturës së ofruar, vihet re se numri i terminaleve të ATM dhe POS në fund të vitit 2012 ka paraqitur rritje përkatësisht prej 2.5% dhe 4%, krahasuar me fundin e vitit 2011.

Kartat janë një instrument pagese me përdorim relativisht të përhapur në Shqipëri vitet e fundit. Megjithatë, shkalla e përdorimit të tyre vlerësohet të jetë ende e ulët krahasuar me vendet e tjera të

rajonit si dhe me potencialin e mundshëm, nëse marrim parasysh se numri i llogarive të klientëve të aksesueshme në distancë, nëpërmjet një karte debiti ose krediti vlerësohet të jetë në masën 28% ndaj totalit të llogarive të klientëve.

Në fund të vitit 2012, numri i kartave në qarkullim është rritur me 5.1% krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar. Nga ndarja e kartave sipas funksionit vihet re një rritje disi më e përshpejtuar e kartave me funksion krediti, me 30%, krahasuar me atë të kartave me funksion debiti të cilat kanë pasqyruar një rritje prej 4%. Duke iu referuar raportimeve të bankave, kartat e debitit zënë rreth 93.6% ndaj totalit të kartave në qarkullim në fund të vitit 2012, krahasuar me 95% në fund të vitit 2011.

Grafik 4. Numri i kartave sipas funksionit dhe ritmet e tyre vjetore.



Rritja e numrit të kartave bankare (debiti dhe krediti) duket të jetë shoqëruar edhe nga një rritje e transaksioneve me to, ku peshën kryesore vijnë ta zënë transaksionet për tërheqje cash. Gjatë vitit 2012, në total janë procesuar rreth 12.4 milionë transaksione me karta (ATM dhe POS), me një qarkullim total prej 123.50 miliardë lekësh. Nga totali i transaksioneve, rreth 91% përbëjnë tërheqje cash nga ATM-të dhe vetëm 9% janë pagesa klientësh me karta në POS-e. Pagesat me karta në terminale POS tregojnë për një mbizotërim të numrit të transaksioneve të kryera nëpërmjet kartave të debitit, ndonëse në terma të vlerës, transaksionet me karta krediti paraqiten ndjeshëm më të larta se ato me karta debiti.

Transaksione me karta sipas llojit të transaksionit	Vëllimi		Vlerë (në milionë lekë)	
	2011	2012	2011	2012
1- ATM tërheqje cash	10,778,879	11,300,261	106,660	109,609
2- ATM depozitime	11.00	5	0.10	0.03
3- Urdhërtransfera nëpërmjet ATM	277.00	80	5.72	0.68
4- Tërheqje cash në terminale POS	2,088	3,450	404	475
5- Pagesa me karta në terminale POS	750,397	1,107,425	10,914	13,396
nga të cilat:				
- pagesa me karta debiti	458,067	656,000	4,719	4,739
- pagesa me karta krediti	292,330	451,425	6,195	8,657
Totali i transaksioneve me karta	11,531,652	12,411,221	117,980	123,481

Burimi: Raportimet e bankave sipas "Metodologjisë për raportimin e instrumenteve të pagesave".

Tabelë 9. Peshë e transaksioneve me karta sipas terminaleve.

Në fund të vitit 2012, 11 banka ofrojnë shërbime "home banking". Përhapja e këtyre shërbimeve reflektohet gjithashtu edhe nga rritja vjetore 48% e numrit të llogarive që aksesohen online. Rritja e këtyre llogarive është pasuar nga shtimi i transaksioneve "home banking" si në numër ashtu edhe në vlerë, duke shënuar kështu një rritje përkatësisht me 26% dhe 29% në krahasim me vitin e kaluar.

Tabelë 10. Ecuria e transaksioneve "homebanking".

Viti	Numri i bankave	Numri i transaksioneve	Vlera e transaksioneve (në milionë lekë)
2005	1	15.706	15.908
2006	1	19.096	16.834
2007	3	42.447	48.492
2008	6	88.261	63.240
2009	10	136.482	78.156
2010	11	162.385	91.277
2011	11	187.431	90.278
2012	11	236.215	117.234

Burimi: Raportimet e bankave sipas "Metodologjisë për raportimin e instrumenteve të pagesave".

IV.2.3 ROLI I BANKËS SË SHQIPËRISË SI MBIKËQYRËSE DHE REFORMATORE E SISTEMIT KOMBËTAR TË PAGESAVE

Në muajin korrik të këtij viti Banka e Shqipërisë përfundoi me sukses projekt-binjakëzimin IPA 2008⁸ me Bankën e Italisë dhe Bankën e Francës, në të cilin sistemi i pagesave pati një rëndësi të konsiderueshme. Tematikat kryesore të trajtuara në këtë projekt konsistuan në fuqizimin e mbikëqyrjes dhe zhvillimin e mëtejshëm të sistemit shqiptar të pagesave.

Më konkretisht, u rishikuan/dhe ose u hartuan një sërë rregulloresh dhe manualesh ndër të cilat mund të veçojmë:

- Rishikimi i dokumentit "Politika e mbikëqyrjes së sistemeve të pagesave dhe shlyerjes" sipas praktikave më të mira ndërkombëtare, ku u zgjerua fusha e zbatimit me qëllim aplikimin e zhvillimeve të viteve të fundit në fushën e pagesave.
- Hartimi i manualit "Për mbikëqyrjen e sistemeve të pagesave", i cili u krye duke përdorur standardet bashkëkohore në përdorim nga bankat qendrore të Bashkimit Evropian.
- Rishikimi i metodologjisë "Për raportimin e instrumenteve të pagesave" nëpërmjet konsultimit me bankat për statistikat që këto të fundit dërgojnë pranë Bankës së Shqipërisë.
- Hartimi i projektregullores "Për operatorët dhe sistemet e pagesave" me qëllim licencimin dhe mbikëqyrjen e operatorëve dhe sistemeve private të pagesave dhe shlyerjes.

Dokumentacioni i lartpërmendur do të shërbejë jo vetëm për fuqizimin e mbikëqyrjes së sistemit të pagesave dhe ofrimin e sigurisë dhe efikasitetit të shtuar në këtë kuadër, por dhe për informimin e mëtejshëm mbi sistemin shqiptar të pagesave (përfshirë instrumentet e pagesave) duke i shërbyer rritjes së transparencës me publikun. Në funksion të objektivit për përmirësimin e infrastrukturës financiare të ofruar nga Banka e Shqipërisë, një hap i rëndësishëm është projekti për përmirësimin e procedurave për administrimin automatik të kolateralit dhe shlyerjen e titujve sipas metodës DVP (delivery versus payment). Ky projekt po hartohet në përputhje me standardet e BE/SEBQ në kuadrin e krijimit të një sistemi qendror të titujve (CSD).

⁸ Projekti IPA 2008 "Për Rritjen e Kapaciteteve Institucionale të Bankës së Shqipërisë".

IV.3 ADMINISTRIMI I REZERVËS VALUTORE

Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë i njuh Bankës së Shqipërisë të drejtën e mbajtjes dhe të administrimit të rezervës valutore të Republikës së Shqipërisë. Banka e Shqipërisë përdor mundësitë e saj më të mira për të mbajtur rezervën valutore ndërkombëtare në një nivel të caktuar, në përputhje me politikën monetare dhe në mbështetje të qëndrueshmërisë financiare të vendit.

Rezerva valutore bruto, e vlerësuar dhe e raportuar në monedhën Euro, është rritur me rreth 64.99 milionë euro gjatë vitit 2012, duke regjistruar në fund të muajit dhjetor vlerën 1,972.48 milionë euro.

Faktorët kryesorë që kanë ndikuar rezervën bruto paraqiten të grupuara si më poshtë.

- *STATISTIKA MBI ECURINË E REZERVËS VALUTORE GJATË VITIT 2012*

A. Veprimet e lidhura me aktivitetin e Ministrisë së Financave kanë patur ndikim pozitiv në shumën 28.64 milionë euro, sipas zërave të mëposhtëm:

- hyrje nga blerje e valutës në treg, 69.08 milionë euro;
- hyrje neto nga lëvrimi i huave të ndryshme, rinovimi i titujve afatshkurtër etj., 134.79 milionë euro;
- hyrje nga privatizime dhe të tjera, 3.65 milionë euro;
- transferata (përfshirë dhe shërbimin e borxhit), 178.88 milionë euro.

B. Veprimet e bankave të nivelit të dytë kanë patur ndikim pozitiv në shumën 33.23 milionë euro, sipas zërave të mëposhtëm:

- derdhje nga bankat e nivelit të dytë në llogarinë e tyre pranë Bankës së Shqipërisë për plotësimin e rezervës së detyrueshme, veprime që lidhen me kapitalin, etj., 134.41 milionë euro;
- transferua, 101.18 milionë euro.

C. Veprimet e Bankës së Shqipërisë kanë patur ndikim pozitiv në shumën 43.98 milionë euro, sipas zërave të mëposhtëm:

- blerje e valutës nga bankat e nivelit të dytë dhe institucione të tjera, 15.29 milionë euro (prej të cilave, 10.6 milionë euro nga bankat dhe 4.69 milionë euro nga institucione të tjera);
- të ardhura të siguruara nga investimi i rezervës valutore, rreth 47.02 milionë euro. Këto të ardhura përfaqësojnë në pjesën kryesore derdhje në formën e kuponave të titujve, në të cilat është investuar rezerva valutore. Efekti i rivlerësimit për portofolin, si rrjedhojë e luhatjes së normave të interesit llogaritet në një vlerë negative prej 24.62 milionë eurosh⁹;
- shlyerje e detyrimeve të Bankës së Shqipërisë ndaj FMN-së, 8.11 milionë euro;
- transferuar, rreth 10.22 milionë euro.

⁹ Kjo vlerë përmban edhe efektin e krijuar nga derdhja e kuponëve të titujve.

Luhatjet në kursin e këmbimit të monedhave në përbërje të rezervës valutore kanë ndikuar negativisht vlerën e rezervës bruto të shprehur në euro, duke regjistruar një efekt prej rreth 16.24 milionë eurosh.

Gjatë vitit 2012 ka vijuar bashkëpunimi i Bankës së Shqipërisë me Bankën Botërore në kuadër të marrëveshjes “Për Administrim dhe Konsulencë në Investimin e Rezervës Valutore” (RAMP). Banka Botërore ka vijuar të ofrojë trajnime dhe programe edukimi të specializuara, në përputhje me nevojat e stafit të Bankës së Shqipërisë. Këto kualifikime, kanë synuar konsolidimin dhe rritjen e mëtejshme të shkallës së profesionalizmit të punonjësve të angazhuar në procesin e administrimit të rezervës valutore si dhe të stafit që mbështet ose monitoron ecurinë e këtij procesi.

Në muajin dhjetor u nënshkrua marrëveshja ISDA (International Swaps and Derivatives Association) me Bankën për Rregullime Ndërkombëtare (BIS). Kjo marrëveshje do t’i mundësojë Bankës së Shqipërisë angazhimin në veprime SWAPS me BIS-in, për qëllime të rritjes së numrit të instrumenteve në dispozicion, me synim përmirësimin e kthimit nga investimi i rezervës valutore.

IV.4 ZHVILLIMI I STATISTIKAVE

Ligji “Për Bankën e Shqipërisë” i njeh institucionit të drejtën e mbledhjes dhe prodhimit të statistikave lidhur me sistemin bankar si dhe të drejtën për hartimin e bilancit të pagesave të Shtetit Shqiptar dhe të metodologjisë përkatëse. Banka e Shqipërisë bashkëpunon me agjencitë e tjera statistikore kombëtare për bashkërendimin e aktiviteteve statistikore, për hartimin e Programit Pesëvjeçar të Statistikave Zyrtare, për hartimin dhe përshtatjen e metodologjive statistikore.

Funksioni statistikor i Bankës së Shqipërisë realizohet nga Departamenti i Statistikave, që administron sistemin e raportimit, aktivitetet dhe metodologjitë statistikore, si edhe realizon prodhimin dhe shpërndarjen e statistikave të Bankës së Shqipërisë. Banka e Shqipërisë është përgjegjëse për prodhimin dhe shpërndarjen e statistikave të mbikëqyrjes bankare, të statistikave monetare dhe financiare dhe të statistikave të Bilancit të Pagesave. Këto statistika përbëjnë lëndën e parë të analizave dhe vendimmarrjes së njësisive të tjera të Bankës së Shqipërisë në funksion të kryerjes së detyrave ligjore të saj. Gjithashtu, Banka e Shqipërisë ka përgjegjësinë e raportimit të të dhënave statistikore pranë agjencive statistikore ndërkombëtare si FMN, Banka Botërore, OECD etj..

- *PRODHIMI DHE SHPËRNDARJA E STATISTIKAVE*

Treguesit statistikorë

Banka e Shqipërisë prodhon rregullisht rreth 4,000 tregues statistikorë, pjesa më e madhe e të cilëve shpërndahen në bazë mujore. Këta tregues publikohen dhe iu vihen në dispozicion përdoruesve në faqen e Bankës së Shqipërisë, si edhe në publikimet periodike si Raporti Statistikor Mujo, Raporti i Politikës

Monetare, Raporti Vjetor i Mbikëqyrjes, Raporti i Stabilitetit Financiar dhe Raporti Vjetor i Bankës së Shqipërisë. Gjatë vitit 2012, baza e të dhënave që publikohen nga Banka e Shqipërisë u pasurua me 5 tabela të reja, me informacion mbi pozicionin e investimeve ndërkombëtare të vendit dhe informacion mjaft të detajuar mbi stokun e investimeve të huaja në Shqipëri sipas shteteve dhe aktivitetit ekonomik.

Integriteti dhe transparencë

Çdo tregues statistikor i prodhuar nga Banka e Shqipërisë garanton plotësimin dhe respektimin e të gjitha parimeve të statistikave zyrtare. Ky standard reflektohet në interesin dhe besimin e përdoruesve brenda dhe jashtë vendit. Banka e Shqipërisë citohet rregullisht në media dhe forume publike si burim i besueshëm, i paanshëm dhe transparent të dhënash statistikore. Baza e të dhënave statistikore në faqen e Bankës së Shqipërisë vizitohet nga një numër i madh përdoruesish dhe është rregullisht një nga nyjet më të vizituara të faqes së Bankës së Shqipërisë.

Kalendari dhe cilësia e statistikave

Respektimi i afateve të publikimit të statistikave është një kusht i rëndësishëm për çdo agjenci statistikore. Statistikat e Bankës së Shqipërisë shpërndahen në përputhje me kalendarin e publikimit të statistikave, që publikohet në fillim të çdo gjashtëmujori në faqen e Bankës së Shqipërisë. Respektimi i këtij kalendari dhe transparencë ndaj përdoruesve mbeten përparësi të rëndësishme të Bankës së Shqipërisë.

Cilësia e statistikave të prodhuara nga Banka e Shqipërisë sigurohet nëpërmjet zbatimit dhe përshtatjes së metodologjive dhe standardeve ndërkombëtare për prodhimin statistikor. Manualët dhe metodikat statistikore iu vihen në dispozicion përdoruesve në publikimet elektronike dhe në formë të shtypur. Manualët kryesore, që udhëheqin prodhimin e statistikave të Bankës së Shqipërisë janë “Metodika e Statistikave Monetare dhe Financiare” dhe “Metodika e Bilancit të Pagesave”, të cilat janë përshtatje me plotësime specifike për vendin të manualeve përkatëse të FMN-së.

Komunikimi me raportuesit dhe përdoruesit

Banka e Shqipërisë mban kontakte të rregullta me njësitë raportuese, agjencitë e tjera statistikore dhe përdoruesit. Në shërbim të rritjes së cilësisë së raportimit, Banka e Shqipërisë organizon herë pas herë aktivitete trainuese me njësitë raportuese, të përfaqësuara kryesisht nga bankat e nivelit të dytë. Gjatë vitit 2012 janë realizuar disa takime dhe seminare trainimi, si edhe janë shpërndarë dy pyetësorë për sistemet e mbajtjes dhe përpunimit të informacionit nga bankat e nivelit të dytë.

• PROJEKTE GJATË VITIT 2012

Gjatë vitit 2012 Banka e Shqipërisë ka ndjekur disa projekte të lidhura me aspekte të ndryshme të prodhimit statistikor. Në fund të gjashtëmujorit të parë të vitit përfundoi Projekti i Binjakëzimit me Bankën e Italisë dhe Bankën

e Francës “Fuqizimi i kapaciteteve institucionale të Bankës së Shqipërisë në fushën e mbikëqyrjes bankare, statistikave, sistemeve të pagesave dhe implementimit të politikës monetare”, si dhe Projekti IPA-2009 nga Eurostat-BE: “Programi rajonal i bashkëpunimit statistikor për vendet e Ballkanit”.

Në kuadrin e Projektit të Binjakëzimit, në fushën e statistikave Banka e Shqipërisë u asistua nga Banka e Italisë. Në modulën e bilancit të pagesave dhe pozicionit të investimeve ndërkombëtare u hartua një model për përmirësimin e mbulimit dhe cilësisë së statistikave të investimeve të portofolit dhe të atyre të investimeve të huaja direkte. Gjatë projektit u hartuan formularë dhe materiale metodologjike, nëpërmjet të cilave synohet përafrimi gradual i sistemit statistikor kombëtar me standardet e Bankës Qendrore Evropiane dhe Sistemit Evropian të Bankave Qendrore. Në modulën e statistikave financiare u punua për ndërtimin e bazës raportuese dhe metodologjike për hartimin e statistikave të transaksioneve financiare për sistemin bankar dhe subjektet jobanka. Objektivi i projektit në këtë fushë ishte ngritja e strukturës për hartimin e llogarisë financiare për sektorin financiar.

Brenda gjashtëmujorit të parë të vitit 2012 Banka e Shqipërisë realizoi me sukses objektivat e projektit IPA-2009 “Programi rajonal i bashkëpunimit statistikor për vendet e Ballkanit” dhe mori vlerësime mjaft pozitive nga koordinatorët e Projektit. Në fokus të projektit ishin statistikave të bilancit të pagesave dhe statistikave ekonomike të ndërmarrjeve rezidente me kapital të huaj dhe filiale jashtë. Në kuadrin e këtij projekti, Banka e Shqipërisë realizoi: raportimin e tabelave të reja statistikore sipas kërkesave të ‘BoP Vademecum’, Eurostat 2010; identifikimin e përmirësimeve metodologjike të nevojshme për plotësimin e kërkesave të Eurostat-it; hartimin e planit të zbatimit të ndryshimeve metodike sipas BPM¹⁰; përgatitjen dhe miratimin nga ekspertët e Eurostat-tit të planit të zbatimit të përmirësimeve metodike për statistikave të bilancit të pagesave. Plani i punës përmban platformën për prodhimin e statistikave të investimeve të huaja, remitançave dhe shërbimeve sipas detajimeve, standardit dhe periodicitetit të parashikuar në ‘BoP Vademecum’, Eurostat 2011.

Në tremujorin e fundit të vitit 2012 filloi projekti për “Automatizimin e Raportimit Rregullator të Bankës së Shqipërisë”. Projekti financohet nga Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim dhe parashikohet të zgjasë për një periudhë dyvjeçare. Objektivi i projektit është vendosja e një sistemi, që do të mundësojë raportimin e automatizuar të të gjitha subjekteve, që raportojnë pranë Bankës së Shqipërisë. Ky sistem do të mundësojë gjithashtu automatizimin e proceseve të kontrollit, përpunimit dhe publikimit të brendshëm të të dhënave statistikore. Sistemi parashikohet të sjellë një sërë dobish duke filluar nga eliminimi i punës manuale, përmirësimi i kontrollit, shkurtimi i kohës së raportimit dhe përpunimit, monitorimi më i mirë i procesit të raportimit, rritja e vëllimit dhe e cilësisë së të dhënave dhe minimizimi ose eliminimi i raportimit të dyfishtë.

¹⁰ “Balance of Payments and International Investment Position Manual, 6th Edition, IMF, 2010”.

IV.5 PUNA KËRKIMORE

Banka e Shqipërisë synon të mbështesë procesin vendimmarrës të saj në themele të forta dijesh dhe njohurish të testuara mbi ekonominë shqiptare. Investimi në krijimin e kapaciteteve të shëndosha kërkimore ndihmon në rritjen e reputacionit dhe të besueshmërisë së Bankës së Shqipërisë si një institucion me njohuritë përkatëse për të garantuar ekuilibrat makroekonomikë të vendit. Për këto arsye, zhvillimi aktiv i kërkimit shkencor zë një vend parësor në strategjinë e zhvillimit të Bankës së Shqipërisë.

Puna kërkimore në Bankën e Shqipërisë ka ndihmuar në rritjen e njohurive mbi ekonominë shqiptare dhe portofolit të materialeve kërkimore kryesisht në fushën e ekonomisë të aplikuar. Këto studime përshkruajnë dhe vlerësojnë ngjarjet ekonomike që kanë përcaktuar dinamikën e zhvillimeve ekonomike dhe investigojnë empirikisht lidhjen ndërmjet këtyre fenomeneve. Vrojtimet statistikore dhe kërkimi teorik mbi vlerësimin e variablave të rastit shumë dimensional për parashikimin e variablave makroekonomikë, kanë plotësuar spektrin e studimit shkencor. Studimi i çështjeve të stabilitetit financiar, politikës monetare, kursit të këmbimit, integritetit rajonal e politikës fiskale, vazhdojnë të mbeten tematika kryesore të studimit të ekonomisë të aplikuar në Bankën e Shqipërisë. Gjatë vitit 2012 kërkimi u fokusua gjithashtu në vlerësimin dhe shpjegimin e ndikimit të krizës së Eurozonës në ekonominë shqiptare dhe vendet e Ballkanit si dhe zgjerimin e portofolit të modeleve makroekonomike me një model financiar për sistemin bankar shqiptar me qëllim monitorimin e tij dhe vlerësimin e performancës në terma të nivelit të kapitalizmit, rrezikut të kredive dhe fitimit të bankave.

Në kuadër të politikës monetare dhe kursit të këmbimit, gjatë vitit 2012 është analizuar roli i parasë si një shtyllë e rëndësishme e politikës monetare të Bankës së Shqipërisë, si dhe shpjegimi i luhatjeve të kursit ditor të këmbimit të lekut ndaj dy monedhave kryesore, euros dhe dollarit. Gjithashtu është parë ndikimi i krizës greke në vendet e rajonit dhe në Shqipëri, si dhe analizimi i natyrës së goditjeve nga ekonomia globale dhe efektet e tyre në ekonominë shqiptare, duke u përpjekur të identifikohet dhe të ndahet ndikimi mes partnerëve kryesorë ekonomikë.

Marrëdhëniet tregtare midis partnerëve tregtarë e vendeve në rajonin e Evropës Juglindore dhe integriteti rajonal, janë bërë objekt i tre materialeve empirike. Fokusi i këtyre materialeve ka qenë, vlerësimi i impaktit të kursit të këmbimit në flukset tregtare të Shqipërisë dhe partnerëve kryesorë tregtarë, matja e nivelit të integritetit të ekonomive në Evropën Juglindore nga këndvështrimi i ciklit të biznesit dhe treguesve makroekonomikë, si dhe studimi i transmetimit të goditjeve në aktivitetin real ndërmjet vendeve partnere në rajon dhe Eurozonë.

Anketimi dhe vrojtimi statistikor kanë vazhduar të mbështesin procesin e vendimmarrjes dhe projektin e qeverisjes së korporatave (banka) përmes llogaritjes së Indeksit të Qeverisjes së Bankave. Databaza e krijuar mbi këtë indeks bëri të mundur vlerësimin e lidhjes së tij me performancën financiare të bankave. Analiza e evidentoi faktin se ka një lidhje pozitive midis disa treguesve

të sistemit bankar dhe indeksit të qeverisjes bankare. Gjatë vitit 2012, vrojtimi u shtri si mjet i kërkimit empirik edhe në fushën e instrumenteve të pagesave. Ky anketim synonte identifikimin e karakteristikave të biznesit dhe të sjelljes konsumatore, që ndikojnë në përdorimin e instrumenteve të pagesave në ekonomi.

Në këtë koncept puna kërkimore i ka shërbyer dhe ka mbështetur procesin vendimmarrës për hartimin dhe zbatimin e politikave të Bankës së Shqipërisë dhe pasurimit të modeleve makroekonomike mbi të cilat mbështetet vendimmarrja. Edhe gjatë vitit 2012, modeli MEAM dhe modelet satelitore të tij janë përdorur për vlerësimin e zhvillimeve të ardhshme të treguesve kryesorë makroekonomikë, si dhe të skenarëve të ndryshëm të rrezikut në terma të stabilitetit të çmimeve, të stabilitetit financiar dhe stabilitetit makroekonomik.

Në faqen zyrtare të Bankës së Shqipërisë, nën kategorinë “Publikime/Kërkime dhe Materiale Diskutimi” do të gjeni një informacion më të detajuar dhe të plotë mbi të gjitha punët kërkimore të Bankës së Shqipërisë, ndërsa një pjesë e artikujve publikohen edhe në Buletinin Ekonomik të Bankës së Shqipërisë. Broshura me frekuencë gjashtëmujore, “Të rejat shkencore në Bankën e Shqipërisë” informon në lidhje me materialet studimore të sapo përfunduara apo ato në proces, materialet e prezantuara në aktivitetin “Seminaret e së Premtes”, apo në aktivitete të tjera të organizuara nga Banka e Shqipërisë gjatë një viti.

- *AKTIVITETET E ZHVILLUARA*

Gjatë periudhës maj-qershor 2012, u organizua nga Instituti i Studimeve Ekonomike dhe Bankare, kursi 2-javor me temë “Administrimi i një anketimi profesional dhe përpunimi i të dhënave të tij bazuar në Excel dhe SPSS”. Qëllimi i këtij kursi ishte marrja e njohurive bazë të stafit të Bankës së Shqipërisë, kryesisht të atyre të angazhuar në pozicione jashtë sferës ekonomike, mbi të ashtuquajturin “anketim profesional”.

Aktivitet i rëndësishëm i organizuar nga Banka e Shqipërisë në bashkëpunim me Universitetin e Oksfordit, ishte seminari i nivelit të lartë, më 14 qershor 2012 me temë “Evropa Juglindore: Parakushtet për Reforma”. Seminari u përqendrua kryesisht në zhvillimet aktuale të ekonomive të rajonit, efekti krizë në këto ekonomi, sfidat me të cilat ato përballen, si dhe reformat apo iniciativat që duhet të ndërmerren në të tashmen dhe në të ardhmen. Fokus të veçantë në diskutime kishin vazhdimësia e reformave në ekonomi, hapësirat e mëtejshme fiskale, si dhe thellimi i mëtejshëm i reformave të gjithanshme strukturore, duke mundësuar kështu koordinimin më të mirë mes politikave ekonomike dhe financiare për të garantuar stabilitetin e mëtejshëm makroekonomik të rajonit. Seminari i organizuar është pjesë e marrëveshjes së bashkëpunimit mes Bankës së Shqipërisë dhe Universitetit të Oksfordit e nënshkruar në shtator të vitit 2010.

Për të gjashtin vit radhazi, më 12-13 nëntor të 2012, u zhvillua takimi rajonal me temë “Kërkimet Ekonomike në Evropën Juglindore”. Në të morën pjesë

25 përfaqësues (prezantues dhe diskutantë) nga Banka e Shqipërisë dhe nga banka qendrore të rajonit, ku përmendim Bankën e Kroacisë, Bankën e Bullgarisë, Bankën e Maqedonisë, Bankën e Hungarisë, Bankën e Çekisë, Bankën e Polonisë, Bankën e Kosovës, Bankën Qendrore Evropiane etj. Qëllimi i këtij aktiviteti ishte përmirësimi dhe rritja e mëtejshme e bashkëpunimit dhe dialogut të hapur midis kërkuesve ekonomikë, si dhe zgjerimi i njohurive të bankave qendrore të rajonit mbi karakteristikat dhe zhvillimet specifike të vendeve pjesëmarrëse. Çështjet kryesore të trajtuara kishin të bënin me financat publike të rajonit, pasiguritë ekonomike dhe mënyrën sesi bankat qendrore mund të veprojnë në mënyrë optimale përballë tyre, me produktivitetin dhe tregtinë, stabilitetin financiar dhe stabilitetin e çmimeve. Këto çështje paraqesin mjaft interes për analizimin e situatës së vështirë ekonomike që ka përfshirë Eurozonën dhe për zgjidhjen saj në vazhdim.

Banka e Shqipërisë (Instituti i Studimeve Ekonomike dhe Bankare) në bashkëpunim me Bankën e Greqisë, organizoi në datën 14 dhjetor 2012, Konferencën e Shtatë Vjetore të Rrjetit të Historisë Monetare për Evropën Juglindore (SEEMHN). Ky rrjet përbën një komunitet historianësh monetarë e financiarë, ekonomistësh dhe statisticienësh, të krijuar në prill 2006 me iniciativën e Bankës së Greqisë dhe Bankës së Bullgarisë. Mikpritja që Banka e Shqipërisë i bëri Konferencës së Shtatë Vjetore të SEEMHN, reflekton mbështetjen e saj kundrejt rrjetit të SEEMHN, objektivi kryesor i të cilit është të përhapë njohuri mbi historinë e politikës monetare të Evropës Juglindore, si pjesë integrale e përvojës evropiane. Tema e kësaj konference ishte: “Rrëfimi i dy krizave: Depresioni i Madh dhe Recesioni i Madh në Evropën Juglindore (Paralele, Administrimi i Krizave dhe Ristrukturime të Sektorit Bankar)”. Banka e Shqipërisë mori pjesë me tre materiale që trajtonin impaktin e krizës greke në Shqipëri dhe në rajon, si dhe politikën fiskale në Shqipëri dhe në vendet e BE-së.

Edhe gjatë vitit 2012, Banka e Shqipërisë ofroi “Çmimin e Guvernatorit për Diplomën më të Mirë” për të gjithë studentët e diplomuar gjatë këtij viti. Ky çmim inkurajon studentët shqiptarë, brenda dhe jashtë vendit, për thellimin në punë shkencore në çështje të lidhura me ekonomiksion monetar, stabilitetin financiar, integrimin ekonomik të Ballkanit në Evropë, veprimtarinë e Bankës së Shqipërisë, sistemin bankar shqiptar dhe ekonominë në përgjithësi. Ky aktivitet përfaqëson një traditë të mirë që shërben për krijimin e një kulture kërkimesh dhe krijimin e një strukture mbështetëse me elementë të rinj, të cilët nuk kanë vetëm dëshirën, por edhe njohuritë e nevojshme për të studiuar.

IV.6 KOMUNIKIMI ME PUBLIKUN

Komunikimi me publikun përbën një hallkë të rëndësishme në aktivitetin e Bankës së Shqipërisë si në përmbushjen e detyrimit për të ofruar transparencë maksimale të vendimmarrjes dhe efektivitetit të saj, ashtu edhe për rritjen e besueshmërisë ndaj këtij institucioni qendror. Një komunikim transparent ndihmon në përmirësimin e cilësisë së vendimmarrjes si dhe në përcjelljen e duhur të politikave të institucionit në ekonomi. Në këtë kuadër, Banka

e Shqipërisë e vlerëson komunikimin ndërveprues me publikun një çështje parësore dhe me rëndësi strategjike në vizionin e zhvillimit afatgjatë të saj, duke i shërbyer realizimit të objektivave dhe detyrave ligjore të Bankës së Shqipërisë.

IV.6.1 INFORMIMI I PUBLIKUT

Banka e Shqipërisë përdor një sërë kanalesh komunikimi për informimin e publikut me qëllim që të shpjegojë sa më qartë objektivin e saj si dhe mënyrën se si e arrin atë. Ndër to mund të përmendim:

- *KONFERENCAT MUJORE PËR SHTYP*

Banka e Shqipërisë, organizon çdo muaj konferencë për shtyp pas çdo vendimmarrjeje të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë mbi politikën monetare, gjatë së cilës Guvernatori i shpjegon publikut vendimin e marrë dhe analizën e përdorur në mbështetje të kësaj vendimmarrjeje. Gjatë vitit 2012, 12 konferencat për shtyp, të organizuara sipas datave të publikuara në një kalendar vjetor në fillim të vitit, janë shoqëruar me publikimin e fjalimeve të Guvernatorit dhe të pyetje-përgjigjeve përkatëse.

- *RAPORTI I POLITIKËS MONETARE*

Si instrumenti kryesor i komunikimit të shkruar të politikës monetare, ky raport përcjell te publiku një tablo gjithëpërfshirëse të zhvillimeve më të fundit makroekonomike dhe faktorëve që kanë ndikuar dhe priten të ndikojnë në ecurinë e çmimeve të konsumit në vend. Gjatë vitit 2012, ai është publikuar rregullisht në formatin e tij tremujor, në gjuhën shqipe dhe angleze.

- *PREZANTIMI I RAPORTIT VJETOR NË KUVEND*

Raporti Vjetor është një publikim i përvitshëm që përshkruan gjendjen ekonomiko financiare të vendit si dhe veprimtarinë e Bankës së Shqipërisë gjatë një viti. Ai i prezantohet çdo vit Kuvendit të Shqipërisë, pas një diskutimi paraprak nga ana e Guvernatorit me anëtarët e Komisionit për Ekonominë dhe Financat.

- *MARRËDHËNIET ME MEDIAN*

Për të patur një komunikim sa më transparent midis Bankës së Shqipërisë dhe publikut, vihen në funksion një sërë instrumentesh, ndër të cilat, më i rëndësishmi është zhvillimi i vazhdueshëm i marrëdhënieve me median e shkruar dhe atë vizive, që siguron informimin në kohë reale mbi vendimet që prekin publikun si dhe mbi aktivitetet e Bankës së Shqipërisë dhe të sistemit bankar në tërësi.

- *DALJET NË PUBLIK*

Guvernatori dhe përfaqësuesit e tjerë të Bankës së Shqipërisë komunikojnë me publikun, nëpërmjet fjalimeve, prezantimeve dhe kumtesave të mbajtura në aktivitete të organizuara nga Banka e Shqipërisë apo institucione të tjera vendase dhe të huaja.

- *DIALOGU ME SISTEMIN BANKAR, BIZNESIN DHE AKADEMINË*

Pjesë e komunikimit me publikun, gjatë vitit 2012 kanë qenë dhe 4 forumet, takimet rajonale e tryezat e diskutimit të organizuara me përfaqësues të sistemit bankar, biznesit, pushtetit vendor, akademisë. Përveç diskutimit të çështjeve të ditës, ato i japin mundësinë Bankës së Shqipërisë të marrë informacion mbi problematikën që kanë sektorë apo rajone të veçanta të vendit.

- *BOTIMET*

Botimet e Bankës së Shqipërisë ofrojnë informacion të zgjeruar e të përditësuar mbi ekonominë shqiptare dhe atë botërore; mbi zhvillimet në sistemin bankar dhe atë financiar; mbi stabilitetin financiar e parane, ndryshimet e pasurimit të legjislacionit bankar dhe kuadrit të tij rregullator si dhe mbi çështje të tjera, duke u konsoliduar kështu si burim i informacioneve të sakta dhe të besueshme për publikun.

Botimet e realizuara gjatë vitit 2012 janë si çdo vit, periodike dhe joperiodike, dhe numërojnë rreth 4533 faqe analiza, statistika dhe studime në gjuhën shqipe dhe atë angleze. Seti i raporteve periodike edhe gjatë vitit 2012 ka ruajtur të njëjtën strukturë: Raporti Vjetor 2012, Raporti i Politikës Monetare (tremujor), Raporti i Stabilitetit Financiar (gjashtëmujor) dhe Raporti i Mbikëqyrjes 2012 (vjetor). Përveç raporteve periodike, kjo gamë pasurohet më tej me Buletinin Zyrtar (mujor), Buletinin e Bankës së Shqipërisë (gjashtëmujor), revistën "Të reja shkencore në Bankën e Shqipërisë" (gjashtëmujore), materialet e diskutimit (9 tituj), librin "Financat personale në duart tuaja", librin e ushtrimeve "Financat personale në duart tuaja" për mësuesit e lëndës, librin "Të ndërtojmë të ardhmen nëpërmjet kulturës financiare", si dhe me botimin e 2 broshurave dhe 3 fletëpalosjeve edukative.

Në funksion të intensifikimit të marrëdhënieve me institucionet kërkimore, ekonomike dhe financiare dhe me këdo tjetër të interesuar si dhe në përmbushje të detyrimit të Bankës për të publikuar, informuar dhe shpjeguar objektivat, politikat, procedurat si dhe opinionet e saj, Banka e Shqipërisë gjatë vitit 2012 ka vijuar politikën e shpërndarjes falas të botimeve të saj.

- *FAQJA E INTERNETIT*

Gjatë vitit 2012, Banka e Shqipërisë ka ofruar transparencë të plotë duke publikuar në kohë reale, në faqen e saj të internetit, informacion mbi aktivitetet e saj dhe sistemin bankar, si fjalime të administratorëve, deklarata dhe njoftime për shtyp, raporte periodike, vrojtime, analiza dhe studime,

statistika dhe tregues të ndryshëm etj.. Gjithashtu, Banka e Shqipërisë, duke identifikuar informimin e publikut si pjesë të përparësive të saj, nga data 27 korrik 2012, publikon në mënyrë periodike, normat e interesit dhe komisionet për produktet dhe shërbimet që bankat në vendin tonë ofrojnë për publikun.

- *STATISTIKAT*

Banka e Shqipërisë zotëron një sistem të pasur statistikash për shumë sektorë të ekonomisë shqiptare, si: sektori bankar, sektori fiskal, sektori real dhe sektori i jashtëm, të cilat publikohen sipas një kalendari të përcaktuar që përditësohet çdo gjashtëmuor. Qëllimi i mbledhjes së këtij informacioni lidhet me qëllimet e bankës qendrore, që janë: hartimi i politikës monetare, kompilimi i bilancit të pagesave si dhe analizimi i sistemit bankar dhe financiar për zhvillimin e këtij sistemi.

IV.6.2 EDUKIMI I PUBLIKUT

Strategjia e komunikimit të Bankës së Shqipërisë, synon, ndër të tjera, edukimin e publikut lidhur me një gamë të gjerë çështjesh, duke nisur nga financat personale e bankingu deri tek ndikimi i drejtpërdrejtë apo i tërthortë që Banka e Shqipërisë luan në mbështetjen e zhvillimit ekonomik të vendit. Edukimi financiar tashmë përbën një domosdoshmëri, duke marrë në konsideratë jo vetëm ritmet e zhvillimit ekonomik, bankar dhe teknologjik, por edhe rëndësinë e peshën që informacioni ka në botën e sotme globale.

Pavarësisht se edukimi i publikut nuk përbën një detyrim ligjor, Banka e Shqipërisë i kushton një rëndësi të veçantë zgjerimit dhe thellimit të kulturës financiare të publikut në vend, e veçanërisht brezit të ri. Masat e parashikuara në strategjinë e komunikimit për këtë qëllim janë zbatuar plotësisht gjatë vitit 2012, duke veçuar, projektin më të spikatur, integrimin e edukimit financiar në kurrikulën e arsimit të mesëm.

- *PROJEKTI PËR EDUKIMIN FINANCIAR NË ARSIMIN E MESËM
“FINANCAT PERSONALE NË DUART TUAJA”*

Projekti për edukimin financiar në arsimin e mesëm bazohet mbi mësimdhënien e lëndës “Financat personale në duart tuaja”¹¹, e cila vjen te gjimnazistët në formën e një moduli me zgjedhje të lirë, me 36 orë mësimore në dispozicion dhe që mund të zgjidhet prej tyre në çdonjërin prej 3 viteve të shkollës së mesme.

Përzgjedhja e lëndës

I prezantuar për herë të parë në vitin 2011, në vitin e dytë të projektit, lënda është zgjedhur nga 9500 nxënës në 127 shkolla të mesme të vendit, duke

¹¹ Teksti është hartuar nga specialistët e Bankës së Shqipërisë, me konsulencën e Institutit të Zhvillimit të Arsimit dhe i miratuar nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës.

rezultuar në rritje nga viti i kaluar, i cili shënonte 7.000 nxënës nga 82 shkolla të ndryshme.

Tabelë 11. Përzgjedhja e modulit “Financat personale në duart tuaja” sipas rretheve, për vitin shkollor 2012-2013.

Njësia administrative	Shkolla që kanë zgjedhur modulën	Nxënës që kanë zgjedhur modulën	Njësia administrative	Shkolla që kanë zgjedhur modulën	Nxënës që kanë zgjedhur modulën
Berat	12	985	Lezhë	9	555
Bulqizë	1	230	Librazhd	12	686
Delvinë	1	72	Lushnje	5	570
Dibër	2	330	Malësi e Madhe	5	174
Elbasan	7	473	Mat	9	450
Fier	8	480	Peqin	2	290

Burimi: Banka e Shqipërisë.

Libri i ushtrimeve për mësuesin

Gjatë këtij viti, ky projekt u pasurua edhe me Librin e Ushtrimeve për mësuesin e lëndës. Në zbatim të objektivave të programit mësimor, në librin e ushtrimeve për mësues jepen zgjidhjet e ushtrimeve të tekstit mësimor “Financat personale në duart tuaja”, si edhe shumë pyetje, ushtrime e detyra të reja, të cilat mësuesit mund t’i përdorin në klasë për të praktikuar njohuritë e përvetësuar në mësim nga nxënësit.

Trajnimi i mësuesve për lëndën “Financat personale në duart tuaja” Një tjetër aktivitet i organizuar nga Banka e Shqipërisë, si pjesë e këtij projekti është dhe organizimi i seminareve trajnuese për mësuesit që shpjegojnë lëndën në klasë. Si një kanal shumë i rëndësishëm për përcimin e saktë të njohurive të trajtuara në tekstin mësimor tek nxënësit, mësuesit kanë nevojë të trajnohen për pasurimin e mëtejshëm të kompetencave të tyre mësimdhënëse për këtë lëndë të veçantë. Në 4 seminare njëditore të zhvilluara përgjatë vitit 2012, 112 mësuesit e trajnuar patën mundësi të njiheshin me të gjitha temat e trajtuara në tekstin mësimor, të ilustruara edhe me shembuj nga realiteti financiar dhe me ushtrime praktike.

Takimet e Guvernatorit me nxënës dhe mësues të shkollave të mesme Gjatë vitit 2012, Guvernatori ka organizuar takime dhe diskutime të hapura me gjimnazistët në disa prej gjimnazeve që kanë përzgjedhur lëndën “Financat personale në duart tuaja”.

- *AKTIVITETE TË TJERA NË FUSHËN E EDUKIMIT*

86- vjetori i monedhës kombëtare

Banka e Shqipërisë organizoi aktivitetin e përvitshëm për përvjetorët e emetimit të parë të monedhës kombëtare shqiptare. Aktiviteti shpalosi gjithë spektrin e vlerave që mbart paraja, jo vetëm si mjet pagese, si dhe trajtoi çështje të lidhura me edukimin financiar. Ai u konceptua si një mini-panair për fëmijët dhe të rinjtë që ndjekin shkollën 9-vjeçare dhe atë të mesme.

Dita Botërore e Mjedisit

Në kuadër të Ditës Botërore të Mjedisit, Banka e Shqipërisë organizoi një aktivitet edukues në formën e një mini-panairi, dedikuar fëmijëve dhe të rinjve që ndjekin shkollën 9-vjeçare dhe atë të mesme, duke ofruar një shumëllojshmëri materiale të shkruara dhe vizuale për t'i njohur nxënësit me rëndësinë jetike që ka mbrojtja mjedisore dhe përparësitë shëndetësore dhe ekonomike të riciklimit.

Bashkëpunimi me Shoqatën Shqiptare të Bankave (SHSHB)

Viti 2012 shënoi edhe bashkëpunimin e parë të Bankës së Shqipërisë me Shoqatën Shqiptare të Bankave (SHSHB) në fushën e edukimit financiar, e cila financoi shtypjen dhe shpërndarjen e 4000 teksteve "Financat personale në duart tuaja".

IV.6.3 AKTIVITETET E MBAJTURA ME RASTIN E 100-VJETORIT TË PAVARËSISË SË SHQIPËRISË

Viti 2012 shënoi një ngjarje të rëndësishme për Shqipërinë: 100-vjetorin e Shpalljes së Pavarësisë. Edhe Banka e Shqipërisë, si institucion qendror i vendit, u përfshi në frymën mbarëkombëtare të festimit, duke dhënë kontributin e saj në fushat përkatëse.

Ekspozita lëvizëse "100 vjet pavarësi: pasqyrimi i historisë në monedhën tonë kombëtare"

Banka e Shqipërisë organizoi ekspozitën numizmatike lëvizëse "100 vjet Pavarësi: pasqyrimi i historisë në monedhën tonë kombëtare" e cila shëtiti në 7 qytete të ndryshme të vendit dhe në Kosovë: Berat, Gjirokastrë, Elbasan, Shkodër, Korçë, Tiranë, Vlorë dhe Prishtinë, duke ofruar gjithashtu edhe një kënd dedikuar edukimit financiar.

Konferenca X ndërkombëtare e Bankës së Shqipërisë "Politika monetare nga e shkuara në të ardhmen"

Në datën 26 tetor 2012, Banka e Shqipërisë organizoi Konferencën X Ndërkombëtare me temë "Politika monetare nga e shkuara në të ardhmen". Konferenca ishte ndërtuar me tre panele: paneli me karakter historik, paneli me karakter aktual dhe paneli i guvernatorëve, i cili mbledhi në një tryezë të përbashkët diskutimi 7 guvernatorë të bankave të ndryshme qendrore.

Rubrika e re: "Banka e Shqipërisë në 100-vjetorin e pavarësisë"

Banka e Shqipërisë krijoi një rubrikë të re në faqen e saj të internetit, me qëllim përkujtimin e kësaj ngjarjeje të rëndësishme dhe informimin e publikut mbi të gjitha aktivitetet që Banka e Shqipërisë organizoi në kuadër të këtij viti jubilar.

IV.7 INTEGRIMI EVROPIAN

Pjesë e objektivave në strategjisë afatmesme të zhvillimit të Bankës së Shqipërisë është realizimi i detyrimeve institucionale të saj në kuadër të procesit të integritimit evropian dhe përafrimi ligjor e rregullativ me *acquis-in* e Bashkimit Evropian. Këto detyrime rrjedhin nga Marrëveshja e Stabilizim - Asociimit (MSA) BE-Shqipëri, e cila përbën kornizën kontraktuale të marrëdhënieve BE-Shqipëri.

IV.7.1 ÇËSHTJE TË INTEGRIMIT EVROPIAN

Shqipëria aplikoi për anëtarësim në Bashkimin Evropian më datë 28 prill 2009 dhe pas plotësimit të një Pyetësori vlerësues të Komisionit Evropian, përfitimi i statusit të vendit kandidat u kushtëzua me plotësimin e 12 prioritetëve, të lidhura me çështjet politike.

Në muajin tetor të vitit 2012 Komisioni Evropian i rekomandoi Këshillit të BE-së dhënien e statusit të vendit kandidat për Shqipërinë dhe rrjedhimisht hapjen e negociatave të anëtarësimit, e kushtëzuar kjo me plotësimin nga ana e Shqipërisë e disa masave të konsideruara kyçe në reformën në administratën publike dhe atë gjyqësore si dhe rishikimin e rregullave proceduralë të Parlamentit.

Në kuadër të Marrëveshjes së Stabilizim - Asociimit (MSA) BE-Shqipëri, Banka e Shqipërisë në përputhje me angazhimet e saj institucionale ka kontribuar në hartimin e Planit Kombëtar të Zbatimit të MSA-së për periudhën 2012 - 2015 në drejtim të identifikimit të situatës aktuale dhe evidentimin e kuadrit rregullativ dhe kapaciteteve administrative në fushat e stabilitetit makroekonomik, politikës monetare, lëvizjes së lirë të kapitalit, të drejtës së vendosjes dhe lirisë për të ofruar shërbime. Gjithashtu janë identifikuar dhe parashtruar prioritetet afatshkurtra dhe afatmesme si dhe nismat ligjore dhe aktivitetet zbatuese për adresimin e tyre, duke parashikuar edhe asistencën e nevojshme teknike si dhe kostot e pritshme të procesit të përafrimit të legjislacionit vendas me *acquis-in*.

Gjatë vitit, Banka e Shqipërisë është përfshirë në dy procese të iniciuara nga Ministria e Integritimit në lidhje me sistemet IT për procesin e integritimit evropian:

- sistemi *online* i PKZMSA-së 2012 – 2015; si dhe
- evidentimi i ndarjes së *acquis-së* së BE-së sipas përgjegjësisë institucionale në një sistem *online* ndërinstitutional.

Më datë 10 tetor 2012 Komisioni Evropian publikoi Raport Progresin për Shqipërinë, i cili përshkruan progresin e bërë nga Shqipëria gjatë periudhës tetor 2011 – shtator 2012 dhe sfidat me të cilat përballet ajo, duke skicuar njëkohësisht edhe përqasjen e Komisionit Evropian, për të udhëhequr dhe mbështetur vendin tonë në të ardhmen. Raport Progresi përshkruan marrëdhëniet ndërmjet Shqipërisë dhe Bashkimit Evropian, analizon

progresin e realizuar në drejtim të kriterëve politike, ekonomike dhe ligjore të anëtarësimit (kriteret e Kopenhagenit), si dhe bën një përmbledhje të vlerësimit të Komisionit Evropian mbi përparësitë dhe problematikat në 33 fushat e ndara sipas *acquis communautaire*.

Për çështjet në lidhje me veprimtarinë e Bankës së Shqipërisë, Komisioni Evropian në Raport Progres, ndër të tjera vlerësoi pozitivisht se është ruajtur stabiliteti makroekonomik, ku politika monetare ka ndihmuar me sukses në ruajtjen e inflacionit në një nivel të qëndrueshëm dhe se sektori bankar mbetet i mirëkapitalizuar dhe likuid.

Banka e Shqipërisë ka përgatitur dhe prezantuar informacionet e kërkuara në takimet periodike midis Shqipërisë dhe BE-së në kuadër të zbatimit të MSA-së.

Në takimin e Komitetit të Stabilizim Asociimit u trajtuan të gjitha arritjet në drejtim të zbatimit të MSA-së. Ky takim përmbledhi të gjitha çështjet e diskutuara në nivel teknik në nënkomitetet e përbashkëta si ato të kriterit ekonomik dhe standardeve evropiane. Në takimin e radhës të Nënkomitetit BE-Shqipëri për Çështjet Ekonomiko-Financiare dhe Statistikat, Banka e Shqipërisë ka raportuar në lidhje me çështjet si zhvillimi i përgjithshëm ekonomik dhe perspektiva, inflacioni dhe politika monetare, sektori i jashtëm, zhvillimet dhe reformat në sektorin financiar bankar.

Në takimin e Nënkomitetit BE-Shqipëri mbi Tregun e Brendshëm dhe Konkurrencën është raportuar mbi punën e Bankës së Shqipërisë në lidhje me përmirësimin e kuadrit rregullator të sistemit bankar dhe atij të lëvizjes së kapitalit. Në përfundimin e këtij takimi, delegacioni i KE-së përshëndeti zhvillimet në kuadrin ligjor dhe rregullator si dhe inkurajoi përafrimin e mëtejshëm ligjor me *acquis-in*.

Një praktikë e re gjatë vitit 2012 ishte ajo e angazhimit të përfaqësuesve të institucioneve shqiptare në hartimin dhe përditësimin periodik të planeve të punës në lidhje me adresimin e rekomandimeve të dala gjatë takimeve të përbashkëta BE-Shqipëri. Banka e Shqipërisë ka plotësuar dhe përcjellë planet e punës përkatëse.

Në kuadër të përmbushjes së detyrimeve që rrjedhin nga Marrëveshja e Tregtisë së lirë të Evropës Qendrore (CEFTA), Banka e Shqipërisë ka kontribuar në plotësimin e skedulit të tregtisë së shërbimeve për Republikën e Shqipërisë. Ky skedul përshkruan statusin aktual të masave diskriminuese ekzistuese lidhur me hyrjen në treg dhe trajtimin kombëtar për ofruesit e huaj të shërbimeve bankare dhe financiare në raport me ofruesit vendas.

Në kontekstin e çeljes së negociatave ndërmjet vendeve anëtare të marrëveshjes CEFTA gjatë vitit 2012, Banka e Shqipërisë është angazhuar në përgatitjen e komenteve mbi skedulën e shërbimeve bankare dhe financiare të Kosovës dhe Serbisë. Këto komente do të shërbejnë si bazë për pikënisjen e negociatave me synimin final hapjen e tregut dhe liberalizimin e mëtejshëm të tregtisë së shërbimeve.

Gjithashtu, Banka e Shqipërisë ka realizuar përcjelljen e informacionit periodik sa i përket notifikimit të akteve ligjore dhe nënligjore të miratuara gjatë vitit 2012, pranë Organizatës Botërore të Tregtisë.

IV.7.2 ASISTENCA NGA BASHKIMI EVROPIAN

Muaji korrik i vitit 2012 shënoi përfundimin e projektit të Binjakëzimit të Bankës së Shqipërisë me Bankën e Italisë dhe Bankën e Francës, projekt ky i financuar nga fondet IPA të BE-së.

Objektivi kryesor i projektit ishte të asistonte Bankën e Shqipërisë në përmbushjen e kriterit ekonomik të Kopenhagenit, duke siguruar zbatimin efektiv të politikës monetare si dhe garantimin e një sistemi bankar të sigurt, të mirëzhvilluar dhe financiarisht të qëndrueshëm në Shqipëri.

Ky projekt u bazua në prioritetet që rrjedhin prej Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit si dhe Partneritetit Evropian, të cilat synojnë ruajtjen e stabilitetit makroekonomik, përforcimin e kuadrit rregullativ dhe atij ligjor të sektorit bankar dhe monitorimin e përgjithshëm të sektorit financiar, përmirësimin si dhe zhvillimin e mëtejshëm të statistikave të ndryshme ekonomike.

Gjatë zbatimit të projektit u realizuan të gjitha aktivitetet e parashikuara në planin e punës dhe produktet finale janë në përputhje me objektivat.

IV.8 BASHKËPUNIMI NDËRKOMBËTAR

Si pjesë e strategjisë së zhvillimit institucional të saj, Banka e Shqipërisë synon të intensifikojë marrëdhëniet dypalëshe dhe bashkëpunimin teknik të vendosur me institucionet financiare ndërkombëtare dhe bankat qendrore. Krahas zhvillimit të mëtejshëm të marrëdhënieve me to, ajo synon gjithashtu përfitimin e asistencës teknike me qëllim forcimin e kapaciteteve njerëzore dhe institucionale.

IV.8.1 MARRËDHËNIET ME FONDIN MONETAR NDËRKOMBËTAR

Republika e Shqipërisë është anëtare e Fondit Monetar Ndërkombëtar (FMN) që prej muajit tetor të vitit 1991. Ajo ndodhet në të njëjtën konstituencë me Italinë, Greqinë, Portugalinë, Maltën dhe San Marinon dhe kryesohet nga përfaqësuesi italian, z. Andrea Montanino, i cili shërben si Drejtor Ekzekutiv i konstituencës që nga muaji nëntor i vitit 2012. Kjo konstituencë ka një total prej 106,404 votash (ose rreth 4.22% të shumës së përgjithshme të votave të të gjithë anëtarëve të FMN-së). Gjatë vitit 2012, kuota e Shqipërisë në FMN ndryshoi nga 48.7 milionë SDR në 60 milionë SDR, si pasojë e rritjes së realizuar në përputhje me reformën e kuotave dhe përfaqësimit të Fondit Monetar Ndërkombëtar të vitit 2008.

Në periudhën shtator-tetor, një mision i FMN-së kreu konsultimet në kuadër të Nenit IV të Neneve të Marrëveshjes së FMN-së. Mbi bazën e vlerësimeve të misionit, Bordi Ekzekutiv i FMN-së, pritet të japë konkluzionet përfundimtare. Sipas raportit paraprak të misionit, që nga fillimi i krizës në vitin 2009 Shqipëria ka shmangur me sukses rënien e theksuar të prodhimit dhe ka ruajtur stabilitetin e sistemit bankar falë politikave të kujdesshme makroekonomike. Raporti vlerësoi politikën monetare përsa i përket ndihmës së dhënë në ankorimin e stabilitetit makroekonomik, si dhe regjimin e inflacionit të shënjestruar dhe kursin e lirë të këmbimit në mbajtjen e inflacionit në nivele të ulëta dhe të qëndrueshme. Ndër të tjera, raporti vëren se sistemi bankar e ka përballuar mirë krizën, falë mbikëqyrjes së kujdesshme dhe nivelit të lartë të likuiditetit dhe kapitalit të bankave.

Guvernatori i Bankës së Shqipërisë ka përfaqësuar rregullisht Republikën e Shqipërisë në vendimmarrjen e Bordit të Guvernatorëve, i cili është organi më i lartë i FMN-së. Një vend të rëndësishëm në marrëdhëniet me FMN-në gjatë këtij viti, kanë zënë edhe mbledhjet e pranverës dhe ato vjetore të FMN-së dhe Grupit të Bankës Botërore, të organizuara përkatësisht në muajt prill dhe tetor, ku delegacioni i Bankës së Shqipërisë, i kryesuar nga Guvernatori, ka zhvilluar takime me përfaqësues të lartë të FMN-së. Këto takime janë përqendruar në zhvillimet më të fundit ekonomike si dhe masat e marra nga ana e Bankës së Shqipërisë në fushën e politikës monetare dhe mbikëqyrjes bankare, me qëllim ruajtjen e stabilitetit makroekonomik dhe rritjen e qëndrueshme ekonomike të vendit.

Gjatë takimeve janë evidentuar marrëdhëniet shumë të mira ndërmjet FMN-së dhe autoriteteve shqiptare si dhe është vlerësuar puna e bërë nga Banka e Shqipërisë, në veçanti ndërmarrja e politikave efektive dhe në kohën e duhur, të cilat kanë ndihmuar po ashtu, në nxitjen e aktivitetit ekonomik të vendit. Përfaqësuesit e FMN-së dhe Grupit të Bankës Botërore kanë inkurajuar autoritetet shqiptare për të vijuar më tej politikat e kujdesshme të ndërmarra, si dhe janë shprehur të gatshëm në ofrimin e asistencës lidhur me ecurinë e krizës ndërkombëtare në të ardhmen.

Në vijim të reformave institucionale të ndërmarra nga FMN-ja, është koordinuar me Ministrinë e Financave pranimi i amendimeve dhe dhënia e pëlqimit për rritjen e kuotës së Shqipërisë në bazë të rishikimit të 14-të të përgjithshëm të kuotave dhe reformës së Bordit Ekzekutiv të Fondit Monetar Ndërkombëtar të vitit 2010. Rezoluta ka si qëllim rritjen e përgjithshme të kuotave në vlerën 100% për të gjithë anëtarët e FMN-së, duke pasqyruar më mirë ndryshimin e peshës relative të vendeve në ekonominë botërore.

IV.8.2 MARRËDHËNIET ME GRUPIN E BANKËS BOTËRORE

Shqipëria është anëtare e Grupit të Bankës Botërore që prej vitit 1991 dhe ka përfituar nga ky institucion një total fondesh prej rreth 1.4 miliardë dollarësh për 71 projekte. Në vitin 2010, Bordi i Drejtorëve të Grupit të Bankës Botërore miratoi strategjinë e re të partneritetit me Shqipërinë për vitet 2011-2014, e cila përqendrohet në tre objektiva strategjike:

- mbështetja e një rimëkëmbjeje në nivelet e rritjes ekonomike të Shqipërisë përmes përmirësimit të kushteve të konkurrueshmërisë;
- zgjerimi dhe mbështetja e përfitimeve sociale nëpërmjet përmirësimit të shërbimeve arsimore dhe shëndetësore; si dhe
- reduktimi i ndjeshmërisë ndaj ndryshimeve klimatike.

Edhe gjatë vitit 2012, bashkëpunimi i Bankës së Shqipërisë me Grupin e Bankës Botërore vazhdoi në kuadrin e marrëveshjes “Për Administrim dhe Konsulencë të Investimit të Rezervës Valutore” (RAMP). Bashkëpunimi gjatë këtij viti ka vijuar me trajnimet e ofruara sipas nevojave për stafin e Bankës së Shqipërisë me qëllim ruajtjen, konsolidimin dhe rritjen e mëtejshme të shkallës së profesionalizmit të punonjësve të angazhuar në procesin e administrimit të rezervës valutore.

Banka Botërore ka vazhduar gjithashtu të financojë pjesëmarrjen e stafit në programe edukimi të specializuara si CFA (Chartered Financial Analyst) dhe CIDA (Certified Investments and Derivatives Auditor). Gjatë vitit 2012 ka vijuar konsulenca në distancë për çështje të lidhura me procesin e administrimit të rezervës valutore, ku ndër të tjera përfshihet edhe përmirësimi i infrastrukturës së teknologjisë së informacionit në mbështetje të aktivitetit të investimit. Gjatë gjysmës së parë të vitit të ardhshëm, pritet të vihet në zbatim një sistem i ri informatik, Portfolio Analytics Tool, për administrimin e rezervës valutore.

Gjithashtu, gjatë vitit 2012, ekipi i sektorit financiar të Bankës Botërore ka vizituar Departamentin e Mbikëqyrjes të Bankës së Shqipërisë me qëllim vlerësimin e krizës së Eurozonës, duke u përqendruar veçanërisht në zbatimin e shpejtë të kuadrit të ri ligjor dhe rregullator. Kontakte të vazhdueshme kanë vijuar edhe me qëllim hartimin e tri udhëzuesve lidhur me çështjen e ristrukturimit të kredive dhe vlerësimit të pasurive të paluajtshme. Banka Botërore parashikon zbatimin e një programi 18-mujor në Shqipëri për të reduktuar numrin e kredive me probleme, me pjesëmarrjen e disa institucioneve vendase. Për zhvillimin e këtij programi, gjatë muajve qershor-shtator 2012, janë realizuar korrespondenca intensive me ekspertët e institucionit ndërkombëtar.

Gjatë mbledhjeve të pranverës dhe vjetore të FMN-së dhe Grupit të Bankës Botërore, delegacioni i Bankës së Shqipërisë ka zhvilluar takime me përfaqësuesit e lartë të Grupit të Bankës Botërore, ku janë trajtuar zhvillimet ekonomike në vend, masat e ndërmarra nga Banka e Shqipërisë në drejtim të ruajtjes së stabilitetit makroekonomik dhe rritjes së qëndrueshme ekonomike të vendit. Nga ana e tyre, përfaqësuesit e Bankës Botërore kanë përgëzuar autoritetet shqiptare për punën e bërë dhe kanë ofruar asistencë në lidhje me rrethanat dhe evoluimin e krizës ndërkombëtare në të ardhmen.

Banka Botërore vazhdimisht ka shprehur gatishmërinë për të ndihmuar Bankën e Shqipërisë në zbatimin e projekteve që kanë për qëllim final konsolidimin, modernizimin dhe qëndrueshmërinë e sistemit bankar shqiptar.

IV.8.3 MARRËDHËNIET ME FSVC-NË

Edhe përgjatë vitit 2012, ka vazhduar bashkëpunimi dhe bashkërendimi i punës me USAID, nëpërmjet programit të zhvillimit të sektorit financiar në Shqipëri, i implementuar përmes VEGA/FSVC-së¹². Asistenca për Bankën e Shqipërisë ka konsistuar në disa projekte me rëndësi kryesisht për mbikëqyrjen bankare, të mundësuar në formën e workshop-eve, seminareve, ekspertizës së ekspertëve apo vizitave studimore, respektivisht në çështjet e mëposhtme:

- procesi i rishikimit mbikëqyrës - workshop-i i organizuar në muajin prill mbi shtyllën e dytë të Bazel II, si pjesë integrale me rëndësi për procesin e mbikëqyrjes së bankave në kuadrin e vlerësimit dhe monitorimit të rreziqeve;
- mbikëqyrja e veprimtarive të leasing-ut dhe faktoring-ut – seminar i organizuar në muajin maj, mbi licencimin dhe mbikëqyrjen e aktiviteteve të shoqërive të leasing-ut dhe faktoring-ut, me qëllim rishikimin e kuadrit rregullativ për mbikëqyrjen e subjekteve financiare jobanka;
- administrimi i rrezikut të kredisë - konsultime dhe ekspertizë, zhvilluar në muajin qershor nga ekspertët e FDIC (Federal Deposit Insurance Corporation) mbi administrimin e rrezikut të kredisë si dhe tema më të avancuara të tilla si vlerësimet e pasurive të patundshme, përqendrimi i kreditimit etj, si pjesë e rëndësishme e analizës dhe procesit mbikëqyrës;
- administrimi i kredive me probleme – workshop-i i organizuar në muajin qershor mbi rëndësinë e parandalimit të hershëm dhe zbulimin e kredive me probleme, taktikat e procesit të negociatave me kredimarrësit, etj;
- zgjidhja e bankave me probleme (bank resolution process) - konsultime dhe ekspertizë të ekspertëve të huaj në fushën e zgjidhjes së bankave me probleme dhe workshop-i me këtë tematikë, zhvilluar përkatësisht në periudhën qershor-korrik, mbi hartimin e një dokumenti me rekomandime lidhur me strategjinë e zgjidhjes së bankave me probleme në rastin e sistemit bankar shqiptar;
- mjaftueshmëria e kapitalit nën dritën e Bazel II - workshop-i i organizuar në muajin shtator mbi shtyllën e parë të Bazel II, i cili ka trajtuar temat si kapitali rregullator për monitorimin e rrezikut të kredisë sipas metodës standarde, teknikat e zbutjes së rrezikut të kredisë, të rejat e Bazel III etj;
- kuadri rregullativ për institucionet e parasë elektronike - ekspertizë dhe vizitë studimore organizuar në muajin nëntor pranë Bankës Qendrore të Kroacisë lidhur me hartimin e kuadrit të nevojshëm rregullativ për licencimin dhe mbikëqyrjen e institucioneve të parasë elektronike, si dhe rregullimin e instrumenteve të pagesës elektronike.

Bashkëpunimi me FSVC-në në fushën e rregullimit dhe të mbikëqyrjes bankare do të vazhdojë të shtrihet edhe në vitin 2013, kryesisht në fushën e përafrimit dhe të përshtatjes në kuadrin rregullativ bankar të legjisllacionit dhe direktivave të BE-së, dhe të eksperiencave më të mira në rajon lidhur me mbikëqyrjen e konsoliduar, Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar etj..

¹² VEGA- Volunteers for Economic Growth Alliance FSVC- Financial Services Volunteer Corps

IV.8.4 MARRËDHËNIET ME INSTITUCIONE TË TJERA FINANCIARE NDËRKOMBËTARE

Përgjatë vitit 2012, Banka e Shqipërisë ka vijuar kontaktet me Bankën Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZH), kryesisht në drejtim të ofrimit të informacionit dhe statistikave për zhvillimet në ekonominë shqiptare në përgjithësi, dhe në sektorin financiar në veçanti. Në Raportin e Tranzicionit 2011, BERZH-i paraqiti përshkrimin e krizës financiare dhe tranzicionit nga perspektiva e individëve dhe familjarëve, bazuar në vrojtimin “Jeta në tranzicion” kryer gjatë vitit 2010. Ky informacion u përqendrua në përshkrimin e vlerësimeve të këtij institucioni për zhvillimet makroekonomike si dhe për reformat ekonomike dhe strukturore në vendin tonë, me një theks të veçantë në analizimin e vlerësimeve të BERZH-it për sektorin financiar bankar dhe atë jobankar në vend, si dhe për kontributin e Bankës së Shqipërisë në këto zhvillime.

Në të njëjtën kohë, gjatë 2012-ës, Banka e Shqipërisë ka vazhduar mbajtjen e marrëdhënieve të ngushta edhe me Bankën për Rregullime Ndërkombëtare, nëpërmjet pjesëmarrjes së Guvernatorit në mbledhjen e përgjithshme vjetore dhe të përfitimit të asistencës teknike për Bankën e Shqipërisë përmes seminareve dhe trajnimeve.

IV.8.5 MARRËDHËNIET ME BANKAT QENDRORE DHE BASHKËPUNIMI TEKNIK

Në vijim të intensifikimit të marrëdhënieve dypalëshe me bankat e tjera qendrore, gjatë vitit 2012, me ftesë të Guvernatorit të Bankës së Shqipërisë kanë zhvilluar vizita në Bankën e Shqipërisë titullarë të institucioneve homologe si: Guvernatori i Bankës Kombëtare të Bullgarisë, Drejtori i Menaxhimit të Bankës së Italisë, Guvernatori i Bankës Qendrore të Bosnje-Hercegovinës, Guvernatori i Bankës Kombëtare të Kazakistanit, Guvernatori i Bankës Qendrore të Malit të Zi, Guvernatori i Bankës Kombëtare të Moldavisë, Guvernatori i Bankës Kombëtare të Republikës së Maqedonisë, Guvernatori i Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës, Zëvendësguvernatori i Bankës Kombëtare të Çekisë, Anëtari i Bordit Drejtues të Bankës Kombëtare të Polonisë etj..

Në të njëjtën kohë, Guvernatori i Bankës së Shqipërisë ka marrë pjesë në shumë konferenca ndërkombëtare, forume dhe seminare rajonale, ku veçohen forumi i 17-të i Evropës Qendrore dhe Lindore, organizuar nga Euromoney, seminari i nivelit të lartë “Evropa Juglindore: Parakushtet për Reforma”, organizuar nga Banka e Shqipërisë në bashkëpunim me Universitetin e Oksfordit, konferenca e 3-të ndërkombëtare mbi investimet e huaja në Shqipëri, organizuar nga AIDA dhe Banka Islamike e Zhvillimit (IDB), konferenca “Konkurrenca kundrejt marrjes përsipër së rrezikut nga sektori bankar në vendet e Evropës Qendrore dhe Lindore”, organizuar në Prishtinë, konferenca e nivelit të lartë organizuar nga Joint Vienna Institute me rastin e 20-vjetorit të krijimit, seminari i 6-të i Kërkimeve ekonomike në Evropën Juglindore etj..

Këto takime, vizita apo konferenca kanë shërbyer jo vetëm për shkëmbimin e përvojave, analizimin e zhvillimeve ekonomike apo diskutimin e masave të marra në kuadër të krizës financiare botërore, por edhe për konsolidimin dhe zhvillimin e mëtejshëm të bashkëpunimit teknik gjithnjë e në rritje ndërmjet Bankës së Shqipërisë dhe institucioneve homologe.

Në planin rajonal, vlen të theksohet pjesëmarrja në takimet e Klubit të Guvernatorëve të vendeve të Detit të Zi, Azisë Qendrore dhe Ballkanit, takime të cilat kanë si qëllim të forcojnë lidhjet midis bankave qendrore të rajonit dhe të nxisin bashkëpunimin rajonal nëpërmjet shkëmbimit të eksperiencës më të mirë e trajtimit në tryeza të rrumbullakëta në nivel guvernatorësh ose ekspertësh të çështjeve aktuale. Në të njëjtën kohë, në muajin maj, Guvernatori i Bankës së Shqipërisë mori pjesë edhe në takimin e Klubit të Guvernatorëve të bankave qendrore të vendeve frankofone.

Në kuadër të bashkëpunimit midis Bankës së Shqipërisë dhe bankave qendrore të rajonit, në muajin qershor u nënshkrua memorandum i bashkëpunimit midis Bankës së Shqipërisë dhe Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës (BQRK), i cili formalizon marrëdhëniet e ndërsjella me qëllim zhvillimin institucional dhe profesional të punonjësve të tyre, nëpërmjet shkëmbimit të përvojave të punës dhe marrjen e njohurive të rëndësishme për realizimin e projekteve që synojnë zhvillimin e institucioneve partnere, të interesave të përbashkët të tyre, si dhe krijimin e një sistemi bankar dhe financiar të zhvilluar dhe të qëndrueshëm. Gjatë vitit 2012, Banka e Shqipërisë ka vijuar ofrimin e ekspertizës teknike për Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës, duke realizuar disa vizita pune të delegacioneve të BQRK-së pranë Bankës së Shqipërisë dhe anasjelltas, të përqendruara në fusha si kontrolli i brendshëm, sistemet e pagesave, mbikëqyrja, burimet njerëzore etj.. Krahas bashkëpunimit në fushën e asistencës teknike me BQRK-në, Guvernatori i Bankës së Shqipërisë ka marrë pjesë në konferencën e përbashkët me Guvernatorin e Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës me temë "Sistemi bankar dhe zhvillimi ekonomik", organizuar në muajin qershor.

Po ashtu, gjatë vitit 2012, Banka e Gjermanisë, Banka e Sllovenisë dhe Center of Excellence in Finance (CEF) kanë qenë ndër ofrueset kryesore të asistencës teknike për Bankën e Shqipërisë, kryesisht nëpërmjet organizimit të vizitave të punës apo dhe internship-eve.

Së fundi, në kuadër të protokollit të bashkëpunimit me Bankën Kombëtare të Serbisë (marrëveshje e nënshkruar në vitin 2009), gjatë vitit 2012 janë organizuar vizita të ndërsjella pune dhe internship-e, të cilat kanë shërbyer për shkëmbimin e eksperiencave për çështje me interes të përbashkët në fusha të ndryshme të bankingut qendror.

IV.9 FORCIMI I KAPACITETEVE INSTITUCIONALE

Banka e Shqipërisë vlerëson se forcimi i kapaciteteve njerëzore dhe kapitale përbën një faktor të rëndësishëm për përmbushjen e objektivit ligjor të Bankës

së Shqipërisë. Në zbatim të strategjisë së zhvillimit të Bankës së Shqipërisë, politikat për zhvillimin e kapaciteteve synojnë orientimin e Bankës së Shqipërisë drejt një institucioni jo vetëm me profil administrativ, por edhe kërkimor, si dhe ngritjen e një infrastrukture pune në përputhje me standardet më të përparuara ndërkombëtare.


IV.9.1 BURIMET NJERËZORE

Punonjësit e Bankës së Shqipërisë janë vlera më e rëndësishme e saj. Forcimi dhe ruajtja e një mjedisi pune motivues për punonjësit, rritja profesionale dhe menaxhimi i karrierës së tyre ndihmojnë krijimin e një kulture pune dhe operacionale të aftë për t'u përshtatur në mënyrë të vazhdueshme me ndryshimet që kërkohen për arritjen e standardeve më të mira për një bankë qendrore.

Investimi sistematik në rritjen dhe zhvillimin profesional të burimeve njerëzore është rruga më e mirë për zhvillimin e institucionit dhe për përgatitjen e stafit për sfida të mëtejshme, të cilat ndihmojnë në përmirësimin e vazhdueshëm të kuadrit rregullativ, strukturor dhe funksional të Bankës së Shqipërisë. Për këtë qëllim, në vitin 2012 janë bërë përpjekje për organizimin e trajnimeve që kanë pikënisje nevojën e Bankës që në kontekstin ekonomik aktual të ketë një staf me njohuri të përditësuara e më të thella të sistemit financiar dhe ekonomisë në tërësi dhe me kompetenca analitike.


Gjatë këtij viti ka vijuar bashkëpunimi i ngushtë me banka homologe, institucione financiare ndërkombëtare¹³ dhe gjithashtu me institucione të tjera, universitete apo qendra të mirënjohura për trajnimet në fushën e bankingut qendror dhe financës. Rreth 63% e aktiviteteve trajnuese janë organizuar nga bankat qendrore dhe institucione të rëndësishme financiare në nivel ndërkombëtar si Fondi Monetar Ndërkombëtar, Banka Botërore, Rezerva Federale e SHBA, BERZH (Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim), Euromoney etj.. Ndërsa 34% e aktiviteteve përfshijnë bashkëpunime me institucione të tjera që ofrojnë mundësinë e shkëmbimit të eksperiencave më të mira financiare, teknologjike etj.

Grafik 5. Shpërndarja e punonjësve sipas nivelit të kualifikimit.



Burimi: Banka e Shqipërisë.


Grafik 6. Aktivitete trajnuese sipas organizatorëve.



Burimi: Banka e Shqipërisë.

¹³ Institucione Financiare Ndërkombëtare - citohet me tej në paraqitjen grafike IFN.

Grafik 7. Aktivitete të zhvilluara në kuadër të projektit të binjakëzimit 2011-2012.



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Tematikat e trajtuara në këto aktivitete kanë patur në fokus çështje që lidhen me mbikëqyrjen bankare, politikën monetare, stabilitetin financiar, politikat fiskale, krizën financiare, menaxhimin e rezervës valutore, sistemin e pagesave, statistikën si dhe çështje të integritetit evropian dhe edukimit financiar.

• *PROJEKTI I BINJAKËZIMIT (TWINNING PROJECT)¹⁴*

Objekti kryesor i këtij projekti binjakëzimi me Bankën e Italisë dhe Bankën e Francës ka qenë forcimi i kapaciteteve institucionale të Bankës së Shqipërisë, veçanërisht në çështje si mbikëqyrja bankare, statistikën, sistemi i pagesave, tregu ndërbankar

dhe zbatimi i politikës monetare, edukimi financiar si dhe bashkërendimi i procesit të integritetit në BE. Për zbatimin e tij është harmonizuar trajnimi dhe asistencën teknike, ku deri në muajin korrik 2012, janë kryer 42 misione nga ekspertë të huaj në Tiranë si dhe 5 vizita pune pranë Bankës së Italisë dhe Bankës së Francës.

Bashkëpunimi i ngushtë me Bankën e Italisë dhe Bankën e Francës në kuadër të projektit të Binjakëzimit ka mundësuar përcjelljen dhe diskutimin e gjerë dhe interaktiv mbi problematikat e ndeshura në kuadër të krizës nga vendet e tyre duke ofruar dhe përvojat dhe praktikën më të mira të zbatuara.

IV.9.2 PËRMIRËSIMI I INFRASTRUKTURËS

Në zhvillimet infrastrukturore të vitit 2012 veçojmë përfundimin e punimeve dhe vënien në punë të ndërtesës së re të Emisionit të Parasë. Kjo është një godinë e re dhe moderne që përfaqëson risi për teknologjinë bashkëkohore të përdorur. Në të, për herë të parë realizohet nëpërmjet një cikli të mbyllur dhe të automatizuar kontrolli, përpunimi, ambalazhimi dhe asgjësimi i kartëmonedhave sipas standardeve më të larta dhe konform normativave evropiane të fushës. Në aspektin e realizimit teknologjik të ndërtesës janë përdorur standardet evropiane në fuqi dhe për herë të parë është instaluar Sistemi Automatik dhe Inteligent i Menaxhimit të Sistemeve Inxhinierike të Ndërtesës.

Ndërtesa e Qendrës së Emisionit të Monedhës është ndërtuar në frymën e një arkitekture moderne, ku spikasin dy skajet rrethore të saj të cilat simbolizojnë monedhën. Duke shfrytëzuar lehtësitë e ofruara nga ndërtesa e re, procesi për përpunimin e parasë do të kryhet me sisteme të automatizuara të shpejtësisë së lartë, duke garantuar kontroll të shpejtë të monedhës përsa

¹⁴ Projekti është mbyllur në muajin korrik 2012.

i përket autenticitetit, gjendjes fizike dhe sigurisë së saj. Kështu, sisteme të automatizuara kryejnë përpunimin e kartëmonedhave me shpejtësi deri në 20 kartëmonedha në sekondë. Këto sisteme kontrollojnë kartëmonedhat për autenticitet dhe njëkohësisht veçojnë kartëmonedhat fizikisht të përshtatshme nga ato të papërshtatshme për riqarkullim, kontrole të cilat mundësohen nga sensorët e avancuar, me të cilat sistemet janë pajisur. Verifikimi i autenticitetit realizohet falë matjeve të përpikta vizuale, si dhe të elementeve magnetike, fosfoeshente, e infra të kuqe të kartëmonedhave. Kontrolli i përshtatshmërisë mundësohet duke matur përmasat, ndotjen, njollat, defektet fizikë si vrimat dhe grisjet, degjenerimin struktural të kartëmonedhave nga përdorimi, praninë e shiritave ngjitës dhe detektimin e mbishkrimeve. Vlen të përmendet që sistemet e përpunimit të instaluar në Qendrën e Emisionit janë të njëjta me ato që përdoren edhe në bankat e tjera qendrore evropiane. Pas përpunimit, kartëmonedhat e përshtatshme për riqarkullim kalojnë në sistemin e paketimit, ndërsa kartëmonedhat e dëmtuara asgjësohen në mënyrë automatike. Për sa i përket përpunimit të parasë, është investuar gjithashtu në pajisje të reja përpunuese të monedhave metalike. Në të ardhmen, planifikohet dhe instalimi i një sistemi tërësisht të automatizuar për ambalazhimin e mëtejshëm të monedhave metalike të përpunuara.

Në Qendrën e re të Emisionit është duke u ngritur dhe një laborator modern si pjesë e Qendrës Kombëtare të Analizës. Nëpërmjet këtij laboratorit, Qendra Kombëtare e Analizës do të mund të kryejë ekspertime profesionale, duke analizuar në detaje karakteristikat dhe elementet teknike të kartëmonedhave dhe monedhave metalike të dyshuara si të falsifikuara. Laboratori bashkëkohor nuk do të ndihmojë vetëm në forcimin e luftës ndaj falsifikimit dhe rritjen e sigurisë së parasë shqiptare, por njëkohësisht do të plotësojë dhe një angazhim të Shtetit Shqiptar në kuadër të Marrëveshjes së Stabilizim-Asocimit. Kapitulli 32 i kësaj marrëveshje, i titulluar "Kontrolli Financiar", përcakton detyrimin e shtetit shqiptar për mbrojtjen e euros nga falsifikimi, detyrim i cili përmbushet me ngritjen e kësaj infrastrukture.

IV.10 KONTROLLI I BRENDSHËM

Në zbatim të ligjit "Për Bankën e Shqipërisë", objektivi kryesor i Departamentit të Kontrollit në Bankën e Shqipërisë është të sigurojë mbarëvajtjen e zbatimit të ligjeve dhe akteve nënligjore në veprimtarinë e Bankës së Shqipërisë. Objektiv tjetër i Departamentit të Kontrollit është të veprojë si një masë kontrolli e përgjithshme dhe shërbim këshillimi për administratorët dhe Këshillin Mbikëqyrës, duke dhënë ndihmesën e tij në drejtim të ruajtjes së integritetit të informacionit, përdorimit eficient të burimeve dhe efektivitetit të sistemeve të kontrollit të brendshëm në Bankën e Shqipërisë.

Veprimtaria e Departamentit të Kontrollit për vitin 2012 u krye në përputhje me planin e auditimit të brendshëm, në zbatim të dispozitave të ligjit "Për Bankën e Shqipërisë" dhe bazës rregullative në fuqi, si dhe në përmbushje të objektivave strategjike të Bankës së Shqipërisë. Plani i auditimit të brendshëm për vitin 2012 (bazuar në vlerësimin e rrezikut të funksioneve/procese

në universin e auditimit) është miratuar nga Inspektori i Përgjithshëm, pas konsultimeve me Guvernatorin dhe anëtarët e Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë.

Gjatë vitit 2012 u realizuan gjithsej 16 angazhime auditimi për dhënie sigurie, nga të cilat janë përfunduar dhe raportuar pranë administratorëve 13 raporte auditimi dhe janë në përfundim 3 raporte auditimi. Dhënia e sigurisë së arsyeshme, mbi mjaftueshmërinë e sistemit të kontrollit të brendshëm të vendosur nga drejtimi për funksionet/proceset e përfshira në auditim, është bazuar në përmbushjen e objektivave të kontrollit: (a) vlerësimi i zbatueshmërisë dhe përputhshmërisë së funksionit të audituar me kuadrin ligjor e rregullativ; (b) vlerësimi i përshtatshmërisë dhe saktësisë së regjistrimeve dhe llogarive kontabël që kanë lidhje me funksionin; (c) vlerësimi i përshtatshmërisë së aplikacioneve të teknologjisë së informacionit që mbështetin funksionin; dhe (d) ndjekja e statusit të rekomandimeve të kaluara.

Për secilin nga auditimet e kryera, vlerësimi i sistemit të kontrollit të brendshëm dhe gjetjet e evidentuara për përmirësim, në formën e rekomandimeve, janë adresuar fillimisht pranë drejtuesve të njësive organizative, subjekt auditimi dhe më pas në vëmendje të administratorëve të Bankës së Shqipërisë. Një përmbledhje e tyre, në formën e raporteve periodike, është paraqitur pranë Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë.

Përveç detyrave funksionale të auditimit, Departamenti i Kontrollit ka dhënë kontributin e tij, në bashkëpunim me njësitë e tjera organizative të Bankës së Shqipërisë, për hartimin e një kuadri rregullativ të formalizuar për evidentimin, ndjekjen dhe raportimin e treguesve kyç të rrezikut, në funksion të administrimit të rrezikut operacional në kryerjen e aktiviteteve kryesore të Bankës.

Në funksion të përmbushjes së objektivit për përmirësimin dhe forcimin e mëtejshëm të kapaciteteve në Bankën e Shqipërisë për adoptimin e zhvillimeve të reja në fushën e auditimit të brendshëm, gjatë vitit 2012 Banka e Italisë ka ofruar asistencë teknike për Departamentin e Kontrollit. Faza e parë e asistencës u konkretizua me organizimin e një seminari 5-ditor nga ekspertët e Bankës së Italisë për stafin e Departamentit të Kontrollit në muajin korrik 2012. Seminari u organizua në tre module trajnimi për forcimin e kapaciteteve të auditimit të brendshëm: (i) njohja dhe zbatimi i Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit të Brendshëm dhe praktikave më të mira; (ii) përmirësimi i njohurive dhe aftësive audituese mbi sigurinë dhe teknologjinë e informacionit; dhe (iii) përmirësimi i njohurive mbi auditimin bazuar në rrezik dhe mbi praktikën më të mira për administrimin e integruar të rrezikut operacional në Bankën e Shqipërisë. Gjatë fazës së dytë të asistencës, planifikuar për t'u shtrirë në një periudhë 1-vjeçare deri në fund të gjashtëmuorit të parë 2013, synohet përmirësimi i bazës rregullative dhe i manualit e procedurave të auditimit të brendshëm në Bankën e Shqipërisë, me qëllim përmirësimin e eficiencës dhe cilësisë së funksionit të auditimit të brendshëm.

Në funksion të përmbushjes së objektivit strategjik për ngritjen profesionale të audituesve të brendshëm, inspektorët e kontrollit janë përfshirë në programe

trajnimi për auditimin e brendshëm dhe menaxhimin e rrezikut të ofruara nga bankat qendrore dhe njëkohësisht kanë ndjekur programe individuale për zhvillimin e tyre profesional për anëtarësime/certifikime pranë institucioneve ndërkombëtare në fushën e kontabilitetit, financës dhe auditimit (ACCA dhe CFA). Gjithashtu, në kuadrin e programit RAMP me Bankën Botërore, u sponsorizua pjesëmarrja e inspektorëve të kontrollit në një trajnim për auditimin e investimeve financiare dhe derivativëve, pjesëmarrje e cila rezultoi e suksesshme me certifikimin CIDA të inspektorëve të kontrollit.

IV.11 NDRYSHIME KRYESORE NË LEGJISLACION

Forcimi i bazës ligjore dhe rregullative përbën një nga objektivat strategjikë të rëndësishëm të shërbimit juridik në Bankën e Shqipërisë. Banka e Shqipërisë synon përshtatjen e akteve ligjore dhe nënligjore të nxjerra prej saj me zhvillimet më të fundit që pësojnë politikën legjislativë bashkëkohore dhe me aktet juridike dhe direktivat e Bashkimit Evropian. Ajo synon forcimin e iniciativës juridike në fushën e hartimit të kuadrit ligjor dhe rregullativ të nevojshëm për sistemin bankar dhe financiar.

Ndër ndryshimet më të rëndësishme në legjislacionin bankar gjatë vitit 2012, theksojmë atë lidhur me skemën e sigurimit të depozitave në vend. Ndërkohë, ka vijuar puna për përmirësimin e kuadrit rregullativ mbi mbikëqyrjen e veprimtarive të bankave dhe institucioneve financiare jobanka¹⁵.

Banka e Shqipërisë dhe ASD, duke marrë shkas nga ndryshimet rregullative që Bashkimi Evropian ka ndërmarrë vazhdimisht në përgjigje të zhvillimeve më të fundit në tregjet ndërkombëtare financiare përgatiti ndryshimet përkatëse në ligjin nr. 8873, datë 29.03.2002 "Për sigurimin e depozitave", të ndryshuar. Ndryshimet në ligjin nr. 8873, datë 29.03.2002 "Për sigurimin e depozitave", të ndryshuar u miratuan nga Kuvendi i Republikës së Shqipërisë nëpërmjet ligjit nr. 78/2012, datë 26.07.2012 "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8873, datë 29.03.2002 "Për sigurimin e depozitave"" të ndryshuar.

Ndryshimet në ligjin për ASD përmbajnë tre momente kryesore, të cilat vlen të theksohen veçanërisht dhe janë renditur më poshtë:

(i) Përfshirja e SHKK-ve në skemën e sigurimit të depozitave

Në projektligj parashikohet përfshirja e SHKK-ve në subjektet e siguruar në skemën e sigurimit të depozitave. Ndryshimet në lidhje me zgjerimin e skemës së sigurimit të depozitave nëpërmjet përfshirjes së SHKK-ve në këtë skemë, janë mbështetur në Direktivën 94/19 të Parlamentit Evropian "Për skemat e garantimit të depozitave", e ndryshuar. Pikërisht neni 3, paragrafi i parë i saj cit. "Asnjë institucion financiar i licencuar në këtë shtet anëtar sipas nenit 3

¹⁵ Për një përshkrim të shkurtër të rregulloreve të reja dhe ndryshimeve në rregulloret ekzistuese, ju lutem referojuni kapitullit "Stabiliteti Financiar dhe Mbikëqyrja Bankare", seksioni "Kuadri Rregullativ", më sipër.


të direktivës 77/780 nuk mund të pranojë depozita nëse ai nuk është anëtar i ndonjë skeme sigurimi.”

(ii) Thjeshtimi i formulës së llogaritjes së primit dhe shumës së kompensimit

Llogaritja e kompensimit të depozitave sipas kërkesës aktuale të ligjit bashkonte cilësitë e kreditorit dhe të debitorit në një të vetme (procesi i netimit), një rregullim ligjor që nuk përputhet me praktikën më të mira ndërkombëtare. Për rrjedhojë, në ligj është parashikuar që procesi i netimit do të shtrihet vetëm tek depozituesit që janë në vonesë të shlyerjes së detyrimeve që kanë ndaj subjektit të siguruar.

(iii) Kontributi i veçantë

Në ligj është parashikuar edhe mbledhja e një kontributi të veçantë nga subjektet e siguruar. Kontributi i veçantë nuk do të konsiderohet si një kontribut i përhershëm por vetëm në rastet kur do të vlerësohet i nevojshëm rindërtimi i mjeteve financiare në rast të kompensimit të depozitave të siguruar ose për shlyerjen e huave të agjencisë, të marra për këtë qëllim. Masa e kontributit të veçantë përcaktohet e njëjtë për të gjitha subjektet e siguruar dhe në çdo rast, jo më shumë se 1% e totalit të depozitave të siguruar që janë regjistruar në subjektin e siguruar në ditën e fundit të muajit pararendës nga data e njoftimit të ASD-së.



Fragment nga basorelievi me qeramika që ndodhet në portalin e hyrjes së selisë qendrore të Bankës së Shqipërisë në Tiranë, autor skulptori italian Alfredo Biagini.